

NOVACIONI NË MËSIMDHËNIE GJATË PANDEMISË

PRAKTIKAT MË TË MIRA

RASTE STUDIMORE **2021**

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:





Të dashur lexues,

Pandemia na mësoi që digjitalizimi në të gjitha fushat e jetës nuk është diçka që i përket së ardhmes, por një realitet aktual. Ky realitet kërkon novacion të vazhdueshëm dhe përshtatjen me një brez të ri që po rritet e formohet në botën virtuale. Në fushën e arsimit në përgjithësi dhe të arsimit profesional në veçanti, mësuesit po përballen me një gjeneratë nxënësish të prirur drejt përdorimit të teknologjisë, të cilët janë më aktivë

dhe performojnë më mirë kur aplikohen forma interesante dhe tërheqëse të mësimdhënies. Kjo i ka ndërgjegjësuar ata gjithnjë e më shumë për nevojën e përfshirjes së teknologjisë dhe metodave aktive të mësimdhënies.

Viti shkollor 2020-2021, i zhvilluar kryesisht në distancë për shkak të pandemisë, e theksoi më tej këtë nevojë. Të mbështetur edhe nga projekti "Aftësi për Punë" drejt intensifikimit të procesit të digjitalizimit të materialeve mësimore, zhvillimit të një sërë webinarëve mbi mësimin online, takimeve dhe diskutimeve të shpeshta etj., një numër gjithnjë e më i madh mësuesish të shkollave partnere të projektit po aplikojnë metoda novatore e interaktive të cilat e bëjnë orën mësimore më angazhuese dhe të suksesshme, si dhe nxisin interesin për të mësuar edhe në mënyrë të pavarur.

Në këtë botim sjellim përvojat 12 mësuesve si praktikant më të mira të aplikimit të këtyre metodave ndërverpuese dhe gjithëpërfshirëse. Nëpërmjet dëshmimeve të tyre, mësuesit na njohin me kontekstin në të cilin janë gjendur, nevojën për novacion, vështirësitë dhe sfidat e ndeshura, impaktin e nismave të tyre në mësimdhënie dhe të nxënë, mësimet e nxjerra, si dhe këshilla se si këto metoda dhe veprimtari mund të replikohen edhe nga mësues të tjerë.

Në "Aftësi për Punë" besojmë se komunitetet e praktikës dhe ndarja e përvojave mes ekspertëve të fushës janë gurthemeli për zhvillimin profesional të mësuesve. Personalisht kam bindjen se ndarja e këtyre përvojave do t'u shërbejë mësuesve të të tjerë shkollave të mesme profesionale e shumë më gjerë si një impuls dhe frymëzim për të reflektuar mbi punën e tyre dhe për ta përmirësuar vazhdimisht atë, për një proces mësimor që përgatit një brez profesionistësh që do të shkëlqejnë në tregun dinamik të punës.

Përzemërsisht i juaji,

Faton Dragoshi

Menaxher Projekti

Projekti "Aftësi për Punë" (S4J)



Të dashur lexues,

Revolucioni digjital ka - dhe do të vazhdojë të ketë - një ndikim thelbësor në arsimin dhe formimin profesional. Kjo sigurisht sjell sfida, por gjithashtu mundësi të mëdha. Arsimi i bazuar në teknologji do të jetë një element "i domosdoshëm" për ofruesit e AFP-së në të ardhmen. Arsimi dhe formimi profesional duhet t'i përshtatet aspekteve të reja në përmbajtje, metodologji dhe në infrastrukturën mësimore. Për këtë, duhet të krijojmë mundësi që ofruesit e AFP-së, mesimdhënësit dhe nxënësit të jenë më novatorë duke përdorur më shumë teknologjitë digjitale.

Duke krijuar sfida të reja në mjediset tona të mesimdhënieve dhe të nxënies, ne aspirojmë të kultivojmë një klimë krijimtari dhe inovacioni.

Një falenderim i madh shkon për të gjithë mesimdhënësit që tashmë janë faktorë suksesi të arsimit dhe formimit profesional në këtë realitet digjital.

Ejvis Gishti

Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

NOVACIONI NË MËSIMDHËNIE GJATË PANDEMISË – PRAKTIKAT MË TË MIRA

Raste studimore 2021

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J).

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

 Rruga Skënderbej, Vila nr. 49
Tirana, Albania, P.O. Box 2891

 +355 42 231 850

 al.info@swisscontact.org

 www.skillsforjobs.al

PËRMBAJTJA

A 05 **Materialet mësimore digjitale**

- 05 Si mund të përfshihet nxënësi si një element i rëndësishëm në validimin e materialeve mësimore - Edlira Brahimi, Shkolla Tregtare Vlorë
- 08 Vendosja e përditshmërisë së nxënësve dhe e praktikës profesionale në fokus të materialit mësimor | Rubrika e analizës në strukturën maipa – Nertila Dundo, Shkolla “Kristo Isak”, Berat
- 10 Krijimi i videove mësimore për një mësimdhënie efektive - Velide Llanaj, Shkolla Tregtare Vlorë
- 13 Kuicet në materialet mësimore digjitale: të vlerësosh progresin duke u argëtuar - Fabiola Grykshi, Shkolla “Salih Çeka”, Elbasan | Ermira Mani, Shkolla “Hamdi Bushati”, Shkodër

B 16 **Metodat aktive të mësimdhënies**

- 16 Përfshirja e rasteve studimore në mësimdhënie dhe vlerësim- Ermira Mani, Shkolla “Hamdi Bushati”, Shkodër
- 19 Jashtë kornizave të mësimiit klasik përmes lojës me role - Entela Progri, Shkolla “Salih Çeka”, Elbasan
- 21 Mësimdhënia tashmë digjitale: si mund të vijë në ndihmë metoda e klasës së përmbysur - Gjenovefa Xhakaj, Shkolla Tregtare Vlorë
- 24 Një kulturë e re e të nxënit: përdorimi i Smartboard në procesin mësimor - Alda Palla, Shkolla “Salih Çeka”, Elbasan
- 26 Projektet ndërleëndore: konceptet në lëndën e matematikës bëhen interesante - Ardita Uka, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë
- 28 Aktivitetet jashtëkurrikulare si një formë alternative e të nxënit - Adriana Prenga, Shkolla “Kolin gjoka”, Lezhë

C 30 **Platformat online**

- 30 Një mënyrë e re e shfrytëzimit të platformës mësovet: portofoli elektronik - Lorena Gjonçaj, Shkolla Tregtare Vlorë
- 32 Programe edukimi global: përdorimi i tyre në ndihmë të nxënësve dhe një kurrikule që i përgjigjet nevojave të tregut - Nilson Ibraj, Shkolla “Gjergj Canco”, Tiranë



Si mund të përfshihet nxënësi si një element i rëndësishëm në validimin e materialeve mësimore

Edlira Brahimi, Shkolla Tregtare Vlorë



Konteksti dhe nevoja

Hartimi i materialeve mësimore cilësore dhe efektive përbën një prej boshteve kryesore ku mbështetet mësimdhënia dhe të nxënësve. Në arsimin profesional, në kushtet kur mungojnë tekstet përkatëse, mbështetja e orës së mësimi në materiale që përcillen të nxënësve nëpërmjet shënimeve (duke i lënë këta të fundit në pozita tërësisht pasive) thjesht nuk funksionon. Nxënësit lodhen shpejt, ndihen të papërfshirë dhe nuk shfaqin interes për t'i përvetësuar këto materiale. Me këtë shqetësim hasej vazhdimisht edhe Edlira, mësuese në Shkollën Tregtare Vlorë. Nisur edhe nga mendimet dhe vështirësitë e nxënësve, ajo ndjente vazhdimisht nevojën e sjelljes së materialeve mësimore në një formë më të përshtatshme e më të pëlqyeshme për ta. Thjesht prurja e tyre në formën e videove, ndonëse përbënte një risi, rezultoi shpejt se nuk mjaftonte, pasi ato jo gjithnjë ishin efikase. Gjithçka nisi në momentin e shfaqjes së një videoje si pjesë e materialit mësimor, e cila shkaktoi reagime të nxënësve për shkak të tejzgjatjes së saj, që sillte vështirësi në përqëndrim.

Atëherë mësuese Edlira vendosi të ndërmarrë nismën e validimit të materialeve mësimore nga nxënësit me synim rritjen e efikasitetit të tyre, duke i përshtatur me profilin e nxënësve dhe interesat e tyre, për një proces të nxëni aktiv dhe novator.

Realizimi

Pasi u konstatua nevoja e rishikimit të materialeve mësimore nga ana e nxënësve që do të shërbente edhe si validim i materialeve, mësuesja vendosi t'i kushtonte këtij procesi një orë mësimore. Nxënësitdo të njiheshin me materialin e ri mësimor, do të diskutonin mbi të, si dhe do të jepnin sugjerime për mënyrën se si mund të përmirësohej. Gjithçka erdhi te nxënësit në formën e një loje, si mënyrë tërheqëse për t'i përqëndruar dhe aktivizuar ata, duke u kërkuar të nxirrnin në pah atë që pëlqënin tek materiali dhe atë që mendonin se duhej të ndryshohej.



PROBLEMI

Nxënës që lodhen shpejt, ndihen të papërfshirë dhe nuk shfaqin interes për të përvetësuar MATERIALET MËSIMORE DIGJITALE.

ZGJIDHJA

Rishikimi i materialeve mësimore nga ana e nxënësve si një formë alternative e ndërtimit të një ore mësimore.

REZULTATI

Përmirësim i materialeve mësimore, i përshtatur me profilin e nxënësve dhe interesat e tyre, për një proces të nxëni aktiv dhe novator.

U realizua si një stuh mendimesh dhe një pinboard, që u përjetua nga nxënësit në formën e një loje. U shfaq materiali dhe nxënësit shënonin në sticky notes anët pozitive dhe anët negative të tij, çfarë u pëlqeu e çfarë jo. Diskutimin të gjithë, edhe ata më pasivët, jepnin feedback dhe ide të reja, pa e kuptuar që në të njëjtën kohë po rrisnin nivelin e të nxënësve të tyre.

Përzgjedhja e imazheve apo tingujve të rinj, shkurtimi i teksteve në formë narrative etj. ishin disa prej përshtatjeve të realizuara. Veçanërisht të vlefshme nga ana e nxënësve ishin idetë e bazuara në praktikën në biznes, duke e orientuar materialin drejt profilit dhe kërkesave të tregut të punës.

“Përpiqem të përfshij atë që nxënësi kërkon, në mënyrë që ta ketë më të thjeshtë në të nxënë dhe për ta aplikuar në biznes në të ardhmen. Në fund të fundit, kjo është e rëndësishme për ta.”

Sfidat nuk kanë munguar. Në fillim, disa prej nxënësve shfaqën rezistencë, duke gjykuar se nuk kishin përse të merreshin me diçka të tillë. Gradualisht, me të kuptuarit më të mirë të procesit dhe me shndërrimin e tyre në protagonistë të orës së mësim, këto rezerva u tejkaluan dhe nisma nisi të japë efekt pozitiv. Procesi është realizuar edhe përtej orës së mësim. Janë dërguar materiale të formateve të ndryshme në Whatsapp, për të parë se si shfaqen në aparate celulare dhe se çfarë mund të ndryshohet për të qenë lehtësisht të shfrytëzueshme.

Si burime për këtë nismë kanë shërbyer materialet mësimore digjitale, të cilat janë gjetur, përkthyer apo përshtatur nga burime të ndryshme, si dhe laptopi, videoprojektori, tabela, shënime ngjitëse, etj., por burimi më i rëndësishëm janë vetë nxënësit, me sugjerimet dhe idetë e tyre për përmirësim dhe pasurim të materialeve mësimore, të cilët janë angazhuar duke krijuar edhe vetë video për këto materiale.

Impakti

Impakti i nismës për kryerjen e vlerësimit dhe validimit të materialeve mësimore me anë të nxënësve gjatë orëve mësimore rezultoi mjaft pozitiv në një sërë planesh:

Përmirësimi i materialeve mësimore bazuar në pikëpamjet, nevojat dhe interesat e nxënësve

Falë shprehjes së mendimit të nxënësve mbi materialet mësimore digjitale dhe dhënies së sugjerimeve nga ana e tyre, këto materiale janë përshtatur dhe janë përmirësuar vazhdimisht në formë dhe në përmbajtje, duke mishëruar këndvështrimin, dëshirat dhe nevojat e tyre, për një proces mësimor më cilësor dhe më efikas.

Rifreskimi dhe shfrytëzimi optimal i orës së mësim


Falë nismës realizohet një orë mësimi ndryshe nga e zakonshmja, ku nxënësit shpeshherë pa e kuptuar mësojnë duke diskutuar e sugjeruar. Kështu bëhet e mundur përcjellja e njohurive të reja, validimi i materialit mësimor, si dhe vlerësimi i nxënësve nëpërmjet aktivizimit të vazhdueshëm të tyre.

Nxitja e formave të ndryshme të vlerësimit

Krahas vlerësimit të nxënësve nga ana e mësueses, një nismë e tillë nxit edhe vlerësimin mes shokëve, falë shprehjes së mendimit mbi sugjerimet e të tjerëve por njëkohësisht edhe vetëvlerësimin, pasi nxënësi duke qenë aktiv arrin të kuptojë progresin por dhe mangësitë e tij.

Angazhimi i vazhdueshëm i nxënësve

Organizimi i mësim bazuar në vlerësimin e materialeve mësimore



dhe validimin e tyre ka krijuar hapësirë që të gjithë nxënësit, edhe ata më pasivë, të mund të angazhohen vazhdimisht, duke shprehur lirshëm mendimin e tyre mbi formën e paraqitjes dhe përmbajtjen e materialit.

Përfshirja e nxënësve në hartimin e materialeve mësimore

Procesi i ka kapërcyer kufijtë e një vlerësimi dhe validimi të zakonshëm të materialeve mësimore. Vetë nxënësit janë përfshirë në hartimin e materialeve, duke kontribuar me realizimin e videove apo animimeve të ndryshme. Ravijëzohet kështu profili i një nxënësi proaktiv, të cilit i krijohen hapësira për të shfaqur aftësitë e tij dhe validimin e tyre ka krijuar hapësirë që të gjithë nxënësit, edhe ata më pasivë, të mund të angazhohen vazhdimisht, duke shprehur lirshëm mendimin e tyre mbi formën e paraqitjes dhe përmbajtjen e materialit.

Konsolidimi i aftësive të buta dhe i kompetencave jetësore

Nëpërmjet kësaj nisme, nxënësit konsolidojnë edhe një sërë aftësish të buta, si: komunikimi, bashkëpunimi, organizimi, shprehja dhe pranimi i mendimit ndryshe, të menduarit krijues, vendosja e prioritetëve etj. Ata aftësohen, përgatiten për të qenë qytetarë më të denjë e më të përgjegjshëm, më të vlefshëm në shoqëri dhe më të përgatitur për t'u integruar në tregun e punës.

Britja e ndërveprimit dhe e komunikimit

Mes mësueses dhe nxënësve, si dhe mes nxënësve me njëri-tjetrin, është vërejtur një shkallë më e lartë ndërveprimi, për një proces mësimor sinergjik dhe më të pëlqyeshëm.

Mësimet e nxjerra

Sipas mësuese Edlirës, ashtu si në çdo nismë tjetër të re dhe aq më tepër kaq komplekse, kishte aspekte ndaj të cilave qasja mund të ishte realizuar ndryshe. Ajo mendon se kjo mënyrë alternative e ndërtimit të orës së mësimi mbi procesin e validimit të materialeve mësimore do të kishte qenë edhe më efektive nëse do të ishte realizuar me disa grupe nxënësish të klasave të ndryshme dhe jo në një klasë të vetme. Marrja në konsideratë e një spektri më të gjerë nxënësish në raport me nivelin e tyre të të nxënës, dëshirat, nevojat dhe perceptimet mbi materialet mësimore digjitale etj. do të rezultonte në materiale më frytdhënëse dhe që i përgjigjen më mirë profilin e nxënësit. Mësuesja këmbëngul në rëndësinë e validimit të materialeve mësimore edhe me kolegë të tjerë, të cilët mund të vijnë me sugjerime të vlefshme për përmirësim. Rëndësi të veçantë ka përfshirja në këtë proces edhe e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët do t'i ndihmonin hartuesit e materialeve për t'i përshtatur më mirë ato me kërkesat e tregut të punës, si dhe do t'i furnizonin materialet me raste studimi e shembuj konkretë nga praktika profesionale.



Vendosja e përditshmërisë së nxënësve dhe e praktikës profesionale në fokus të materialit mësimor | Rubrika e analizës në strukturën MAIPA

Nertila Dundo, Shkolla “Kristo Isak”, Berat



Konteksti dhe nevoja

Arsimi profesional në Shqipëri është përfshirë në një proces transformimi të vazhdueshëm, për t'u përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe për të rritur punësueshmërinë e nxënësve. Dinamika e ndryshimeve ka bërë që të ketë mungesë të teksteve për lëndët profesionale në drejtime dhe profile të ndryshme. Kjo mbetet një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen mësuesit. Në një situatë të tillë, lind nevoja e hartimit të materialeve mësimore digjitale si një burim i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe si “zbutës” i mungesës së teksteve. Këtu lind një sfidë tjetër për mësuesit, të cilët duhet të hulumtojnë burime të ndryshme, të përzgjedhin, të editojnë dhe të përshtasin, për të krijuar materiale mësimore cilësore dhe efektive për version digjital. Që materiali të vijë i plotësuar, nuk duhet të mungojnë aktivitetet për të evidentuar pëmbushjen e objektivave mësimorë apo rezultateve të të nxënësve.

Nertila Dundo, mësuese në shkollën “Kristo Isak” në Berat, u prezantua për herë të parë me këtë qasje të quajtur “Rubrika e analizës” në trajnimin me tematikë “Hartimi i materialeve digjitale”. Duke parë përfitimet nga kjo qasje, mësuese Nertila vendosi ta integrojë atë në të gjitha materialet digjitale që harton, duke e bazuar në situata të njohura për nxënësit, në raste e përvoja konkrete, të supozuara ose të përjetuara nga vetë ata.

Duke sjellë situata të lidhura me praktikën profesionale të nxënësve, mësuese Nertila jo vetëm vendos nxënësin në qendër të materialit mësimor, por edhe krijon një urë lidhëse mes teorisë së përfutur në klasë dhe praktikës në biznes, si një prej boshteve në të cilat duhet të mbështetet arsimi profesional në tërësi.



PROBLEMI

Të kuptuarit e shkallës së pëmbushjes së objektivave mësimorë vetëm nëpërmjet riprodhimit të informacionit nuk garanton efektivitet.

ZGJIDHJA

Përfshirja në materialet mësimore e rubrikës së analizës mbështetur në situata të përditshmërisë së nxënësve dhe në përvojën e tyre gjatë praktikave profesionale.

REZULTATI

Shkallë më e lartë angazhimi dhe motivimi të nxënësit dhe qartësi më e madhe në pëmbushjen e objektivave mësimorë.

Realizimi

Procesi i hartimit të materialeve mësimore u zhvillua sipas strukturës MAIPA, duke zbatuar hapat e rekomanduar gjatë trajnimit nga ekspertët zviceranë në hartimin e materialeve digjitale, LerNetz. Rubrika e analizës, e cila përkon me atë të reflektimit për të kuptuar nëse procesi i të nxënësve ka qenë i suksesshëm, kërkon vëmendje të veçantë në konceptim. Siç dëshmon mësuese Nertila, për ta bërë sa më të gjallë e konkrete për nxënësit, për të nxitur angazhimin e tyre, si dhe për t'i shërbyer funksionit që ajo ka - të kuptuarit e shkallës së arritjes së objektivave mësimorë - analiza u realizua duke u mbështetur në metoda e situata konkrete. Përzgjedhja e këtyre metodave bën të mundur zbatimin e njohurive të ndërtuara nga nxënësit në situata reale apo të ngjashme nga jeta dhe profesioni i ardhshëm. Kështu, mundësohet të nxënësve nga përvoja, duke krijuar një binom tashmë të sprovuar: përvoja në shërbim të mësimin dhe mësimi në shërbim të krijimit të përvojës. Mësuese Nertila shpjegon se fillimisht procesi i realizimit të analizës ashtu si edhe strukturimi i materialit mësimor në tërësi sipas skemës MAIPA nuk ishte i lehtë. Ai kërkonte kohë, shqyrtim të nivelit të nxënësve dhe të aftësive të tyre, ballafaqim të vazhdueshëm me objektivat mësimorë dhe mbi të gjitha kreativitet dhe qëndrim empatik. Me kalimin e kohës dhe krijimin e përvojës në përshtatjen e strukturës dhe në realizimin e analizës, vështirësitë u zbehën, ndërkohë që aplikimi i kësaj rubrike gjatë orëve mësimore vërteton efektivitetin e saj.



M

Mirëseardhja



A

Aktivizimi
i njohurive
ekzistuese



I

Informimi



P

Përpunimi
dhe
transferimi



A

Analiza

Impakti

Ashtu si zbatimi i tërë rubrikave të strukturës në tërësi, edhe ai i analizës, i vendosur në një plan më të afërt me botën e nxënësve, përvojën dhe interesat e tyre, po rezultojnë të suksesshëm. Efektiviteti vërehet si në orët e mësimin edhe në punën e pavarur të nxënësve, falë aksesit në çdo kohë në materialin mësimor. Mësuese Nertila thekson se nxënësit janë më të interesuar, pasi në mjaft raste ndihen edhe të përfaqësuar, duke e pasuruar diskutimin me prurje personale. Ata ndihen më të përfshirë, më aktivë, më të lirshëm për të shprehur perceptimet dhe qëndrimet e tyre. Tek nxënësit nxiten edhe aftësitë krijuese e kritike dhe jo thjesht riprodhimi i materialit mësimor. Kështu, nxënësit ndërtojnë më mirë aparatin e kompetencave për t'u përgatitur për jetën dhe profesionin. Në të njëjtën kohë, impakti pozitiv ndihet edhe te vetë mësuesja, e cila kupton më mirë shkallën e arritjes së objektivave mësimore, si dhe vështirësitë dhe mangësitë e nxënësve, duke nxjerrë në pah edhe aspektet që kërkojnë përmirësim. Për më tepër, ashtu si të gjithë komponentët e skemës MAIPA, analiza lehtëson punën e mësuesit në përgatitjen e planit ditor.

Mësimet e nxjerra

Mësuese Nertila tregon se një nga mësimet e nxjerra gjatë procesit të realizimit të materialit mësimor në tërësi dhe të rubrikës së analizës në veçanti, është rëndësia që duhet t'i kushtohet secilit komponent të një materiali mësimor, pasi cilido prej tyre ka funksionin e tij të qartë dhe është ngushtësisht i lidhur me të tjerët. Konkretizimi i rubrikës së analizës kërkon nga mësuesi hulumtim, kreativitet dhe intuitë për të kuptuar se si t'u afrosh nxënësve duke iu referuar interesave të tyre apo veprimtarive të përditshme, si dhe si t'i motivosh ata. Ndërkohë, bashkëpunimi me mësues të tjerë në kuadër të hartimit të materialeve mësimore digjitale, por edhe ndërveprimi me botën e biznesit rrit mundësitë për një produkt edhe më cilësor. Temë pas teme, gjithçka kristalizohet dhe bëhet më e lehtë për mësuesin, si dhe më e qartë për nxënësin, i cili familjarizohet me një qasje të tillë analitike. Për ta bërë sa më efektive rubrikën e analizës, mësuese Nertila sugjeron përqendrim në objektivat mësimorë të përcaktuar, hulumtim të vazhdueshëm në burime të ndryshme informacioni, larmi rastesh e situatash të përdorura dhe larmi formash të paraqitjes digjitale, frymëzuar edhe nga tema tashmë të digjitalizuara në platformën MësoVET, si dhe shkëmbim idesh e përvojash mes kolegësh dhe përfaqësuesish të bizneseve.

“Gjatë rubrikës së analizës janë përdorur metoda të tilla, si: metoda me situata konkrete, metoda me projekte, metoda e simulimit, firma ushtrimore etj. Përzgjedhja e këtyre metodave bën të mundur zbatimin e njohurive të ndërtuara nga nxënësit në situata reale apo të ngjashme nga jeta dhe profesioni, pra realizimin e të mësuarit nëpërmjet përvojës.”

Krijimi i videove mësimore për një mësimdhënie efektive

Velide Llanaj, Shkolla Tregtare Vlorë



Konteksti dhe nevoja

Përdorimi i metodave tradicionale të mësimdhënies, mbështetur praktikisht në një burim të vetëm – shpjegimi me fjalë i mësuesit – tashmë është provuar se nuk mjafton dhe nuk garanton efektivitet. Përfshirja e një prezantimi në PowerPoint, me fjalë e foto “të ngrira” nuk përbën më risi dhe efekti i tij në përqëndrimin dhe shtimin e interesit të nxënësve është gjithnjë e më i ulët, ndërkohë që ajo që ata i tërheq është digjitalja, dinamika dhe e larmishmja. Këtë e kanë konstatuar gradualisht edhe mësuesit, të cilët e kanë orientuar procesin e mësimdhënies dhe materialet mësimore digjitale drejt formave novatore, të mbështetura në avantazhet që krijon teknologjia. Në drejtimin Hoteleri-Turizëm të shkollës Tregtare Vlorë, mësuese Velide Llanaj tregon se prej kohësh ishte ndërgjegjësuar që, nëpërmjet shpjegimit klasik, shkalla e përqëndrimit të nxënësve nuk ishte e kënaqshme. Për më tepër, specifikat e fushës e bëjnë të vështirë të kuptuarit e materialit mësimor thjesht nëpërmjet të folurit apo shfaqjes së imazheve statike. Ajo kuptoi se ndërthurja e koncepteve me një larmi të madhe procesesh, teknikash, modelesh etj. shtron nevojën e demonstrimit të tyre, në mënyrë që nxënësit ta ndjekin, të përpiqen ta imitojnë dhe gradualisht të krijojnë shprehitë e duhura profesionale.

Ndaj mësuese Velidejandërmori nismën e krijimit të videove mësimore me qëllim prurjen e informacionit të ri në një formë ndryshe, më të plotë, më të përshtatur me specifikat e lëndës apo modulit në fushës dhe me efekt më të madh përqëndrues, tërheqës dhe angazhues.

Fillimisht u përdorën për demonstrim video të gatshme, për t'i mundësuar nxënësve ndjekjen hap pas hapi të këtyre proceseve e teknikave. Integrimi i aspektit pamor lëvizor, të ndërthurur edhe me titra, si dhe atij dëgjimor, natyrisht përbënte një avantazh dhe i tërhiqte nxënësit, por videot e gatshme jo gjithnjë përkonin me përmbajtjen e lëndës apo modulit apo me objektivat mësimore ose rezultatet mësimore të synuara. Në sytë e mësuese Velidesë, u kristaliza nevoja për krijim videosh të reja.



PROBLEMI

Informacion i ri i ardhur te nxënësit në formë « të vakët », duke ulur interesin dhe përqëndrimin tek ata.

ZGJIDHJA

Krijimi i videomësimore të përshtatura me përmbajtjen e lëndës dhe kontekstin, dukeorientuar procesin e mësimdhënies dhe materialet mësimore digjitale drejt formave novatore shumë të pëlqyera nga nxënësit.

REZULTATI

Transmetim i informacionit në mënyrë efektive, përthithje më e shpejtë e teknikave dhe proceseve specifike, si dhe aktivizim i nxënësve gjatë orës mësimore.

Realizimi

Puna e mësueses për krijimin e videove mësimore nisi me një fazë hulumtuese në internet për gjetjen e programeve të përshtatshme dhe pa pagesë. Gjatë kërkimit në burime të ndryshme, perceptimi i saj mbi videot, përmbajtjen e tyre, elementet përbërëse dhe pritshmëritë në efektin që krijojnë, ndryshuan tërësisht, duke kuptuar rëndësinë që kishte çdo detaj në produktin final. Për mësuese Velidenë, gjetja e programit më të përshtatshëm për realizimin e videove nuk ishte e thjeshtë. Në hapat e parë, filloi të punonte me programin Flexclip, i cili ishte tejet i kufizuar në numrin e videove që mund të realizoje pa pagesë, si dhe mernte kohë të gjatë në krijimin e tyre, duke i shkruar, prerë dhe montuar për t'i përshtatur me konceptin qëndror. Më pas, nisi të përdorte Biteable, një program i thjeshtë në përdorim, me minutazh të pakufizuar dhe që krijonte mundësi të gjeje dhe të bashkoje imazhe (slide) tërheqëse për t'i sjellë në trajtë videoje. Por fondi i këtyre imazheve ishte i limituar dhe gjithashtu nuk lejonte krijimin e skenave lëvizëse. Gjatë intensifikimit të punës për hartimin e materialeve mësimore digjitale për platformën MësoVET, një kolege i sugjeroi Powtoon, një program të cilin mësuese Velideja e kishte ndeshur edhe më parë. Nëpërmjet Powtoon, të cilin vazhdon ta përdorë edhe aktualisht, mësuesja ka realizuar shumë video. Falë kësaj pune intensive, mësuesja fitoi përvojë, duke përsosur aftësitë konceptuale dhe ato teknike, të ndërthurura me ato pedagogjike. Ajo tregon kujdes të veçantë për çdo element, që nga ndërtimi i skenarit, te përzgjedhja e mënyrës së paraqitjes, karakteret, ngjyrat, fjalët dhe muzika. Përpjekjet janë përkthyer në krijimin e videove gjithnjë e më cilësore, si në përmbajtje, edhe në formë.

Siç ndodh me çdo nismë të re, edhe mësuese Velideja është përballur me sfida. Vështirësitë më të mëdha i ka ndeshur në zanafillën e nismës, pasi përfytyrimi dhe konceptimi i videove, si dhe zbërthimi i të gjithë komponentëve, nuk ishte diçka e lehtë. Gjithashtu, kostot e programeve kufizonin disa tipareve të videove, si ngjyrat apo qartësinë e imazhit, ndërkohë që nuk mungonin as problemet e herëpashershme me linjën e internetit. Ndonëse falë përvojës së fituar i përballon më lehtësisht vështirësitë apo dilemat në zgjedhjet që duhet të bëjë, për mësuese Velidenë ka një sfidë që nuk rresht asnjëherë. Nxënësit kërkojnë gjithnjë larmi dhe risi, ndaj edhe çdo mësues duhet të përpiqet maksimalisht për t'iu përgjigjur atyre.

Impakti

Impakti i realizimit të videove mësimore dhe i përdorimit të tyre gjatë orës së mësimi si dhe i ndjekjes së tyre nga ana e nxënësve në kuadër të punës së tyre të pavarur, është mjaft pozitiv. Nëpërmjet videove, nxënësit mund të njihen konkretisht me procese dhe teknika të cilat nuk mund të realizohen as në kushte reale, si psh. gjatë praktikës profesionale. Vlera e tyre është ndjerë edhe më shumë gjatë periudhës së mësimi në distancë, pasi transmetohen në mënyrë më efektive te nxënësit, në një hark kohor më të shkurtër. Nxënësit i shohin me kërkshëri videot, janë më të përqëndruar, më të prirur për të komentuar dhe

për të drejtuar pyetje. Mësuese Velideja konstaton me kënaqësi se me përdorimin e videove mësimore, numri i nxënësve që aktivizohen gjatë orës së mësimi ka ardhur në rritje. Gjithashtu, fakti që nxënësit janë më pranë teknologjisë dhe së resë në tërësi, i bën ata vlerësues të mirë të videove, duke dhënë sugjerime mbi elemente të caktuara si: imazhet e përdorura, mënyra e integritit të tekstit, muzika në sfond etj. Kjo jo vetëm që e ndihmon mësuesen të përmirësojë vazhdimisht të videove, duke ua përshtatur edhe më mirë preferencave të nxënësve, por edhe i nxit ata të gjykojnë dhjetë vlerësojnë, të sjellin ide të reja, të zhvillojnë mendimin kritik, duke u ndjerë edhe të dobishëm. Në të njëjtën kohë, përshtatja e videove sipas sugjerimeve të tyre i bën ata më të interesuar kundrejt një produkti në të cilin ndjejnë se kanë kontribuar dhe kjo ndikon ndjeshëm në shkallën më të lartë të përqëndrimit dhe në përvetësim më të mirë të informacionit.

Ngarkimi i videove në platformat online, si MësoVET, në kuadër të materialeve mësimore digjitale, është një tjetër avantazh që shoqërohet me impakt pozitiv, pasi nxënësit kanë mundësi t'i rishohin videot vazhdimisht edhe në mënyrë të pavarur, përtej orës së mësimi, duke përthithur më mirë informacionin e sjellë në to dhe duke përsosur më tej teknikat, modelet, procedurat etj. Nga integrimi i videove të krijuara apo të përshtatura, materialet mësimore digjitale bëhen më të larmishme, më të gjalla dhe më tërheqëse, ndaj edhe interesi për t'i shfrytëzuar nëpërmjet platformës është më i madh.



« Nxënësit i ndjekin me kërshtëri videot, diskutojnë mbi mesazhin e tyre sipas mënyrës se si ata e perceptojnë, si dhe japin sugjerime për ta përmirësuar. Këto janë metoda tërheqëse në mësimdhënie, që nxisin pjesëmarrjen e sa më shumë nxënësve. »

Mësimet e nxjerra

Që nga ideja për të realizuar videot e para mësimore e deri tani, mësuese Velideja pohon se ka mësuar shumë, si në aspektin teknik, edhe në atë pedagogjik. Hap pas hapi, videot e saj vijnë më të strukturuar, më tërheqëse, me mesazhe më të qarta. Ato janë më të përshtatura si me qëllimin që kërkojnë të përmbushin, ashtu edhe me atë që nxënësin preferojnë. Sipas mësuese Velidesë, avantazhet e botës digjitale duhen shfrytëzuar më së miri në procesin mësimor dhe askush nuk duhet të hezitojë me idenë se nuk arrin të përshtatet apo nuk mund t'ia dalë mbanë të realizojë atë që synon. Duhet dëshirë ndaj së resë, pasion, përkushtim, si dhe durim për të krijuar përvojën e duhur, por avantazhet janë të mëdha dhe mundësitë për ta bërë mësimin më ndërveprues dhe më atraktiv nëpërmjet aplikimit të teknologjisë janë të pafundme. Me mbarimin e procesit të hartimit të materialeve mësimore digjitale, mësuesja ka planifikuar të hartojë një manual për përgatitjen e videove mësimore, avantazheve krahasuese në raport me mënyra të tjera të transferimit të informacionit të ri të nxënësit dhe impaktit pozitiv të tyre në të nxënë.



Kuicet në materialet mësimore digjitale: të vlerësosh progresin duke u argëtuar

Fabiola Grykshi, Shkolla "Salih Çeka", Elbasan
Ermira Mani, Shkolla "Hamdi Bushati", Shkodër



Konteksti dhe nevoja

Në sektorin arsimor në vendin tonë, integrimi i metodave të mbështetura në teknologji dhe shfrytëzimi i avantazheve të qasjeve të tilla ka nisur relativisht vonë dhe ecën me hapa të ngadaltë. Kushtet infrastrukturore jo gjithnjë favorizuese, aftësitë digjitalepërgjithësisht të kufizuara, si dhe mbizotërimi i një mendësie rezistente ndaj së resë, bëjnë që ndërthurja e metodave tradicionale të mësimdhënies me ato bashkëkohore me mbështetjen e teknologjisë, të jetë një sfidë e vërtetë. Gjithsesi, gjithmonë e më shumë kërkohen mënyra të reja, motivuese dhe tërheqëse për nxënësin, për ta vendosur atë në qendër të orës së mësimi, për ta nxitur drejt punës së pavarur dhe për përforcuar ndërveprimin.

Në shkollën "Hamdi Bushati" në Shkodër, mësuese Ermira Mani po punon intensivisht me përgatitjen e materialeve mësimore digjitale për platformën MësoVET. Sipas saj, shqyrtimi i përparimit të nxënësit në raport me njohuritë e ofruara duhet të realizohet në vazhdimësi, duke integruar instrumente matëse përgjatë gjithë materialit mësimor digjital, lehtësisht të aplikueshme edhe gjatë orës së mësimi. Në materialet e saj, mësuesja i kushton rëndësi përgatitjes së pyetjeve të shpeshta e të shpejta, në formë kuicë dhe loje, që shpesh marrin edhe ngjyrat e një konkursi mes nxënësve.

Ndërkohë, në shkollën "Salih Çeka" në Elbasan, mësuese Fabiola Grykshi pasi është njohur me materialet e platformës që mësuese Ermira ka hartuar dhe digjitalizuar, ka nisur t'i përdorë gjatë orëve të saj të mësimi. Për mësuesen Fabjolën, e cila është e re në profesion, mundësia për të zhvilluar orën e mësimi nëpërmjet platformës dhe veçanërisht për të realizuar kuice të tilla me nxënësit vjen në kohën dhe formën e duhur. Një qasje e tillë, i përgjigjet më së miri nevojës së saj për të organizuar sa më mirë orën mësimore, për të monitoruar nivelin e përvetësimit të njohurive të nxënësit dhe për të përsosur qasjen metodike në raport me performancën e nxënësve.



PROBLEMI

Aktivizim i ulët i nxënësve në përpjekjen tradicionale nga mësuesit për të kuptuar shkallën e përvetësimit me shtrimin e disa pyetjeve të mbyllura në fund të orës.

ZGJIDHJA

Përfshirja e kuiceve në materialet mësimore digjitale si një formë argëtuese dhe tërheqëse për të kuptuar shkallën e përvetësimit të njohurive.

REZULTATI

Të kuptuarit më të qartë të progresit të nxënësve në përthithjen e informacionit, identifikim i mangësive dhe vështirësive, si dhe rritje e angazhimit dhe e ndërveprimit.

Ndaj mësuese Velidejandërmori nismën e krijimit të videove mësimore me qëllim prurjen e informacionit të ri në një formë ndryshe, më të plotë, më të përshtatur me specifikat e lëndës apo modulit në fushës dhe me efekt më të madh përqëndrues, tërheqës dhe angazhues.

Fillimisht u përdorën për demonstrim video të gatshme, për t'i mundësuar nxënësve ndjekjen hap pas hapi të këtyre proceseve e teknikave. Integrimi i aspektit pamor lëvizor, të ndërthurur edhe me titra, si dhe atij dëgjimor, natyrisht përbënte një avantazh dhe i tërhiqte nxënësit, por videot e gatshme jo gjithnjë përkonin me përmbajtjen e lëndës apo modulit apo me objektivat mësimore ose rezultatet mësimore të synuara. Në sytë e mësuese Velidesë, u kristaliza nevoja për krijim videosh të reja.

Realizimi

Në aspektin konceptual, mësuese Ermira i ndërton pyetjet bazuar në objektivat mësimore dhe konceptet kyçe të informacionit të ri. Mësuesja synon të sjellë një larmi pyetjesh në kuic, si psh. ato të tipit “e vërtetë / e gabuar”, pyetje me alternativa, pyetje me plotësime të vendeve bosh etj. Të tilla pyetje natyrisht nuk përbëjnë teste të mirëfillta, por vlejné pasi nxjerrin në pah se sa nxënësi ka arritur t'i përvetësojë njohuritë e përcjella. Si burime kryesore për përgatitjen e kuiceve, mësuese Ermira përmend njohuritë teorike të saj mbi hartimin e njësive të testit, si dhe trajnimet e realizuara me projektin, veçanërisht trajnimin “Bazat e didaktikës”, në të cilin ka marrë pjesë edhe si trajnuese. Trajnimet mbi platformën MësoVET dhe krijimi i përvojës gjatë digjitalizimit të materialeve mësimore, kanë qenë po ashtu të vlefshme për ndërtimin e kuiceve.

Në anën tjetër, gjejmë mësuese Fabiolën, e cila është përdoruese e këtyre kuiceve, si pjesë e materialeve të plota mësimore. Mësuesja nisi ta përdorte platformën gjatë orëve të mësimi nëpërmjet programit Zoom, duke ndarë me nxënësit përmbajtjen e ekranit dhe duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe kuicet. Gjithashtu, ka përdorur me sukses edhe kuicin e parashikuar për orën e përsëritjes.

Procesi ka patur edhe vështirësi. Për mësuese Ermirën, periudha në të cilën është realizuar pjesa më e madhe e materialeve mësimore ishte e mbushur me sfida. Ndonëse nisma erdhi si përgjigje e kalimit të menjëhershëm në mësimin online për shkak të pandemisë, përgatitja e materialeve mësimore nuk ishte e lehtë. Mbingarkesa në shkollë, domosdoshmëria për t'u përshtatur shpejt me metodat e reja të mësimdhënies dhe gjendja emocionale e rënduar për të gjithë ishin pengesa jo të vogla. Njëkohësisht, vështirësitë nuk mungojnë as gjatë orëve mësimore për shkak të problemeve të ndryshme teknike. Në rastet e linjës së dobët të internetit, mësuese Ermira e ka gjetur zgjidhjen duke përdorur Smart TV dhe duke e realizuar mësimin nëpërmjet tij, ndërkohë që kuici është realizuar drejtpërdrejt nga celulari i çdo nxënësi. Fillimisht, janë ndeshur vështirësi edhe në shfrytëzimin e kohës në dispozicion, pasi ora mund të ngarkohet me dhënie të informacionit të ri, duke mos mundësuar zhvillimin e kuicit. Me kalimin e kohës dhe fitimin e përvojës, situata është menaxhuar lehtësisht. Sfida të ngjashme në përdorimin e platformës dhe rubrikës së kuicit ka ndeshur edhe mësues Fabiola. Për të, vështirësitë janë hasur në fillim të përdorimit të platformës për mësimdhënie për shkak të mungesës së përvojës, por gradualisht, duke e shfrytëzuar platformën dhe kuicet në çdo orë mësimi, këto pengesa janë kapërcyer dhe ora ka rezultuar e suksesshme.

“Ata zbaviten, sfidojnë veten e tyre, por edhe vlerësojnë njohuritë e tyre, nxënë nëpërmjet kuicit, kuptojnë mangësitë dhe i plotësojnë ato.”

Ermira Mani



Impakti

Kuicet vijnë si plotësuese të një pakete të plotë komponentësh, ku në një material mësimor digjital gjendet “akullthyesi”, aktivizohen njohuritë e fituara më parë, jepen koncepte teorike, ilustrime, tema për diskutim, raste studimi, etj. Janë të shumta efektet pozitive të përdorimit të kuiceve gjatë orës së mësimi, aq më tepër të zhvilluara nëpërmjet platformës. Kështu:


- mësuesi arrin të kuptojë se sa i vëmendshëm ka qenë nxënësi gjatë orës së mësimi, sa e ka përthithur ai informacionin e ri dhe sa janë përmbushur objektivat mësimorë
- kuici e ndihmon mësuesin të kuptojë edhe se sa rezultate ka qenë ora e mësimi, materiali mësimor dhe metodat të mësimdhënies që ka aplikuar, duke u ndërgjegjësuar edhe mbi nevojat për ndryshim dhe përmirësim
- nxënësi merr vëmendjen e mësuesit dhe vendoset në qendër të orës së mësimi
- nxënësi ndërgjegjësohet mbi njohuritë e fituara, por edhe mbi mangësitë, duke u nxitur t'i plotësojë, si dhe mëson nga gabimet e tij
- nxënësi ndihet më i motivuar dhe forcon vetëbesimin e tij
- procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit bëhet më angazhues dhe ndërveprues, pasi të gjithë marrin pjesë dhe shkëmbejnë mendime mbi përgjigjen e duhur
- arrihen të përfshihen të gjithë nxënësit, madje ata më pasivë e më indiferentë, pasi ora e mësimi bëhet më tërheqëse e madje edhe argëtuese
- thyhet monotonja e informacionit teorik, shpesh voluminoz e të lodhshëm
- falë pranisë së kuicit në platformë, nxitet edhe puna e pavarur e nxënësit, pasi nxënësi mund ta testojë veten kudo dhe kurdo, duke insistuar deri në dhënien e përgjigjes së saktë, qoftë edhe për kënaqësinë që ai moment ofron
- tipet e pyetjeve të përfshira në test, të shkurtra dhe që marrin pak kohë për t'u përgjigjur, baraspeshojnë, në një material mësimor, ngarkesën që krijohet nga pyetjet e hapura

“Nxënësit mbahen të aktivizuar gjatë gjithë orës.”

Fabiola Grykshi

Mësimet e nxjerra

Mësuese Ermira tregon se rëndësinë e kuiceve e ka kuptuar nëpërmjet përgatitjes së tyre për platformën, duke u ndërgjegjësuar mbi vlerën që do të kishin nëse do të zhvilloheshin gjatë orës mësimore. Ajo shpjegon gjithashtu se suksesi në realizimin e kuiceve është jo vetëm në varësi të hartimit të pyetjeve apo larmisë së tyre, por edhe të mënyrës se si ofrohet i gjithë materiali në platformë (teksti, imazhet, skemat, diskutimet etj.). Pyetjet duhet të mos jenë të lodhshme për nxënësit, por të shkurtra dhe tërheqëse. Në këtë mënyrë, shfrytëzohet siç duhet edhe avantazhi që krijon zhvillimi i kuicit në platformë, nëpërmjet feedback-ut të menjëhershëm pas dhënies së përgjigjeve. Sipas mësuese Ermirës dhe mësuese Fabjolës, duhet të mbahen gjithnjë në konsideratë edhe kufizimet e kuiceve, pasi ato nuk janë të mjaftueshme për të realizuar vlerësimin e nxënësve. Mësuese Ermira shprehet se do të dëshironte të mernte më shumë input nga mësues të tjerë në lidhje me kuicet, por edhe nga nxënësit, për të kuptuar më shumë mbi shkallën e vështirësisë së tyre apo nevojën për t'i integruar më shpesh, si dhe për të identifikuar tipet e pyetjeve më tërheqëse. Nga të dyja mësueset, vjen një sugjerim i bazuar në nevojë: shoqërimi i kuiceve edhe me një test në përfundim të çdo teme, që do t'i përmbahej kriterëve të hartimit të njësive të testit. Një element i tillë do të kompletonte më tej materialet mësimore digjitale.



Përfshirja e rasteve studimore në mësimdhënie dhe vlerësim

Ermira Mani, Shkolla "Hamdi Bushati", Shkodër



Konteksti dhe nevoja

Përgatitja e një materiali mësimor, ashtu si edhe organizimi i një ore mësimi mbështetur mbi të, nuk është një proces i lehtë. Mësuesit i duhet të mbajë në konsideratë paralelisht një sërë aspektesh: materiali mësimor dhe ora e mësimit të realizohen në mënyrë të tillë që të garantojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënësit apo objektivave mësimorë, të përcjellin siç duhet njohuritë të nxënësit, të ndërthurin aspekte teorike me ato praktike, të mundësojnë një vlerësim mbi bazën e shkallës së arritjes së synimeve të paracaktuara, por njëkohësisht edhe të nxitin angazhimin e të gjithë nxënësve, t'i shtyjnë nxënësit drejt punës së pavarur, t'i pajisin me kompetencat kyçe dhe të konsolidojnë tek ata aftësitë e buta. Pavarësisht dëshirës së mirë, shpesh kjo qasje shumëpërmasore rezulton e vështirë në aspektin e përzgjedhjes së metodave që do të aplikohen dhe veprimtarive mësimore të përfshira. Si rrjedhojë, shpeshherë mësuesit mjaftohen me një format tradicional të mësimdhënies dhe të nxënësit, mbështetur në shpjegimin dhe riprodhimin e informacionit të ri. Ndërkohë, instrumentet për ta pasuruar dhe për ta bërë më efektiv procesin e të nxënësit janë të pafundme.

Në shkollën "Hamdi Bushati" në Shkodër, mësuese Ermira Mani po e mbështet gjithnjë e më shumë punën e saj në prurjen e rasteve të studimit, si gjatë përgatitjes së materialeve mësimore digjitale edhe gjatë zhvillimit të orës së mësimit.

Përfshirja e shpeshtë e rasteve të studimit synon pikërisht ofrimin e materialeve dhe orëve mësimore të një natyre tjetër, ku nxënësi është aktori kryesor dhe procesi i fitimit të njohurive, kompetencave dhe aftësive i kapërcen kufijtë e zakonshëm, duke u shtrirë natyrshëm në situata, problematika dhe përvoja me të cilat nxënësit janë familjarë.



SHKOLLA PROFESIONALE
HAMDI BUSHATI

PROBLEMI

Orë dhe materiale mësimore të mbështetura në riprodhim njohurish teorike dhe teknike, me mundësi të pakta për nxënësit për të analizuar, vlerësuar dhe shprehur kreativitetin e tyre.

ZGJIDHJA

Prurja e rasteve të studimit referuar situatave të njohura për nxënësit, nëpërmjet diskutimit ballë për ballë apo forumeve, punës individuale apo në grup.

REZULTATI

Përvetësim më efektiv i njohurive mbështetur në shembuj konkretë, zhvillim i mendimit kritik dhe kreativ të nxënësve dhe përmbushje më rezultative e objektivave mësimorë.

Nxënësi, tashmë aktor kryesor, nuk mjaftohet thjesht me përthithjen e aspekteve teorike e teknike për profesionin e tij të ardhshëm, por i jepet mundësia të gjykojë, të analizojë, të vlerësojë e të japë zgjidhje kreative, ashtu siç do t'i duhet të veprojë edhe në të ardhmen e tij, si pjesë e tregut të punës dhe si një qytetar i denjë e i përgjegjshëm.



Realizimi

Mësuese Ermira tregon se para fillimit të punës për gjetjen dhe përshtajen e rastit të studimit, është e rëndësishme të kuptohet se integrimi në material i një rasti studimi nuk është qëllim në vetvete për çdo çështje apo tematikë. Për këtë arsye, hapi i parë është të reflektohet mbi faktin nëse përdorimi i një rasti studimi i përshtatet përmbajtjes së çështjes dhe objektivave mësimore. Vetëm më pas, nis puna për kërkimin e rastit të studimit. Burimi kryesor i rasteve të studimit për mësuese Ermirën është interneti. Kërkimin e realizon në gjuhën angleze, duke vendosur fjalët kyçe në motorin e kërkimit. Në pjesën më të madhe të rasteve, ajo shfrytëzon Google Scholar, pasi ofron një mori rastesh interesante me fokus aktual. Përparesi u jep atyre që i përshtaten më shumë shoqërisë sonë, tregut tonë të punës, profesionit të ardhshëm të nxënësve dhe situatave të përditshme me të cilat ata ndeshen. Gjithashtu, përqëndrohet në raste studimi të shkurtra, jo të ndërlikuara e jo të lodhshme për nxënësin, duke synuar përfshirjen sa më të gjerë të tyre. Rasti i studimit mund të jetë i përshtatshëm në versionin origjinal të tij, si në fokusin, ashtu edhe në mënyrën e trajtimit apo në pyetjet me të cilat shoqërohet, por mund të ndodhë edhe që të nevojitet riformulim i pyetjeve apo çështjeve të ngritura për diskutim, për t'i përshtatur më mirë me objektivat mësimore apo niveline nxënësve.

“Sa më familjar të jetë për nxënësit një rast studimi, aq më mirë e më të sigurtë do të ndihen ata për t'u përfshirë në të gjatë trajtimit.”

Një ndër avantazhet e mbështetjes në një rast studimi është fleksibiliteti në realizimin e tij. Mund të vijë në formë narrative ose nëpërmjet një videoje, mund të zhvillohet si në klasën fizike, nëpërmjet një diskutimi të hapur, ashtu edhe online, nëpërmjet forumeve të ndryshme. Në të njëjtën kohë, edhe format e zhvillimit të tij janë të ndryshme. Mund të jepet si detyrë individuale ose në grup, gjatë orës së mësimit ose si detyrë shtëpie, duke nxitur kështu edhe punën e pavarur të nxënësve. Në varësi të tematikës, mund të realizohet edhe në formë prezantimi (angl. gallery walk), ku nxënësit njihen me punën e njëri-tjetrit, ndërveprojnë dhe japin vlerësime, si dhe mund të shërbejë edhe për orën e përsëritjes, duke i kushtuar edhe më shumë kohë diskutimit.

Mësuese Ermira tregon se kërkimi i rasteve të studimit nuk është gjithnjë i lehtë. Ndonjëherë mund të gjenden të gatshme ose të kenë nevojë thjesht për përshtatje, por në raste të tjera, i duhet

t'i hartojë vetë. Një sfidë tjetër qëndron në integrimin e rastit të studimit në orën mësimore, aq më tepër në kushtet e pandemisë, kur ora e mësimi zgjat vetëm 30 minuta. Kur koha nuk premton, mësuesja gjen zgjidhje, duke iu referuar materialit mësimor në platformën MësoVET dhe duke e caktuar rastin e studimit si detyrë shtëpie. Po ashtu, sfidues mund të jetë edhe vlerësimi i nxënësit mbi një rast studimi, pasi përgjigjet janë shpesh subjektive. Në të njëjtën kohë, diskutimi mbi rastin e studimit mund të rrezikojë të mos i përmbahet boshtit tematik, ndaj edhe mësuesi duhet të menaxhojë me kujdes situatën dhe kohën.

Impakti

Ka një sërë efektesh pozitive me të cilat shoqërohet sjellja e një rasti studimi nga ana e mësuesit. Kjo metodë krijon hapësira të shumta për të nxitur nxënësit të angazhohen. Nxënësit vihen në lëvizje, aktivizohen më shumë. Është një formë tërheqëse për të gjitha nivelet e nxënësve, pasi secili ka dicka për të thënë. Krijohet një "efekt domino", ku mjafton të aktivizohen 2-3 nxënësit e parë dhe të gjithë gradualisht çlirohen dhe fillojnë të ingranohen.

Edhe nxënësit më indiferentë, vijnë me ide e zgjidhje interesante, pasi mund të kenë qenë vetë në pozita të ngjashme apo mund ta njohin situatën nëpërmjet njerëzve të tjerë. Pa e kuptuar, nxënësit shfaqin shkallën e njohurive të tyre, paralelisht me konsolidimin e kompetencave kyçe, si për shembull qëndrimi i duhur ndaj të tjerëve. Fryma e diskutimit dhe e debatit nxitet gjithashtu, sidomos në raste studimi ku natyrshëm ravijëzohen qëndrime pro dhe kundër, për një mësimdhënie dhe të nxënë bazuar në ndërveprim. Veçanërisht aktivë nxënësit janë gjatë zhvillimit të rasteve të studimit që lidhen me përvojën profesionale në biznes. Njëkohësisht, rastet e studimit mundësojnë edhe përmbushje të objektivave mësimorë, konkretizim të përmbajtjes së materialit mësimor, nxitje të punës së pavarur, si dhe nxitje të shpirtit të punës në skuadër kur jepen në formë detyre në grup. Paralelisht, përfshirja e rasteve të studimit në materialet mësimore digjitale të platformës MësoVET mundëson atraktivitet më të lartë të materialit dhe interes të shtuar nga ana e nxënësve.

"Ne duam t'i përgatisim për tregun e punës, që të jenë gati për t'u përballur me situata të ndryshme e të gjejë zgjidhje përballë problemeve që mund t'u shfaqen."

Mësimet e nxjerra

Mësuese Ermira shpjegon se një ndër mësimet kryesore të nxjerra ka të bëjë me të vlerësuarit paraprakisht se sa një rast studimi i përshtatet një çështjeje dhe objektivave mësimorë të saj. Gjithashtu, ajo këshillon të bëhet kujdes nëse planifikohet që rasti i studimit të përfshihet në test, pasi këndvështrimet, perceptimet dhe përvojat e nxënësve janë të ndryshme, mendimet janë subjektive dhe shpesh është e vështirë të realizosh pikëzimin mbi to. Rastet e studimit duhet të jenë të përshtatura me aktualitetin dhe kontekstin ku nxënësit jetojnë dhe veprojnë dhe, që të jenë rezultative, duhet të lidhen me interesat e tyre dhe veprimtaritë e tyre. Janë një mënyrë mjaft e mirë edhe për të thyer monotoninë në materialin mësimor, për ta bërë më tërheqëse mësimdhënien dhe të nxënës, si dhe për t'i shpërtuar riprodhimin të thjeshtë të informacionit që merret. Forma në të cilën rastet e studimit vijnë duhet të synojë tërheqjen e vëmendjes së të gjithë nxënësve, edhe të atyre më pak të interesuar, ndaj nuk duhet të jenë të tejzgjatura apo të komplikua, si dhe duhet t'i përshtaten nivelit të nxënësve. Në të njëjtën kohë, ndonëse në qendër vendoset nxënësi, mësuesi duhet të jetë vazhdimisht vigjilent për të orientuar diskutimin dhe për t'i dhënë mundësi të gjithëve të shprehin, si dhe duhet të ushqejë debatin me pyetje e ngacmime të herëpashershme. Në platformën MësoVET, mësuese Ermira këshillon sjelljen e rasteve të studimit në trajtë forumesh, ku secili nxënësi, kur dhe ku ai dëshiron apo ka mundësi, të japë argumentet e veta, si dhe të mund të komentojë dhe vlerësojë mendimet dhe idetë e shokëve.



Jashtë kornizave të mësimit klasik përmes lojës me role

Entela Progri, Shkolla "Salih Çeka", Elbasan



Konteksti dhe nevoja

Standardet e reja në institucionet arsimore nuk e kufizojnë vlerësimin e performancës së një nxënësi vetëm në faktin se sa mirë ai e ka përvetësuar përmbajtjen specifike të kurrikulës. Përkundrazi, ato synojnë të vlerësojnë shkallën në të cilën këta të rinj kanë fituar njohuri të zgjeruara dhe aftësi cilat do t'ju nevojiten në të ardhmen. Për këtë arsye, nga mësuesit kërkohet që të udhëhiqen nga ideja se ata që sot janë nxënës të tyre, nesër do të jenë profesionistët e kërkuar në tregun e punës. Krahas njohurive të profesionit, atyre do t'u duhet patjetër të kenë përvetësuar edhe edukatën e punës në grup, aftësitë komunikuese, të menduarit kritik dhe aftësitë për t'u adaptuar - aftësi të listuara në çdo ofertë punësimi.

Gjatë procesit mësimor, Entela Progri, mësuese e drejtimit TIK në shkollën "Salih Çeka", ka në fokus gjithëpërfshirjen e nxënësve nëpërmjet mësimitdhënies me në qendër nxënësin. Për këtë arsye, ajo është gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja të mësimitdhënies që e ndihmojnë në arritjen e objektivave të një ore mësimore. Ajo pohon se nëse do të vazhdonte me metodat klasike, sidomos në orët e përsëritjes ku duhet evidentuar si dhe sa janë përvetësuar konceptet e dhëna, mbase nuk do t'i realizonte të gjitha pritshmëritë e saj. Ajo nuk do të kishte mundësi ta kthente klasën në një mjedis ku çdo nxënësi i krijohet hapësira për të shfaqur më të mirën e tij, pa u ndrojtur e pa u stepur, duke u shprehur lirshëm si në një bisedë mes shokësh.

"Si çdo mësues, e kam përparësi gjithëpërfshirjen dhe sidomos të nxënit me në qendër nxënësit. Këto arsye më bëjnë që të jem gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja që të më ndihmojnë në arritjen e këtyre synimeve."



PROBLEMI

Vështirësia e matjes së përthithjes së informacionit nga nxënësi, në një ambient "të ngrysur", ku mungon interaktiviteti dhe gjithëpërfshirja.

ZGJIDHJA

Aplikimi i "Lojës me role" në kuadër të punës me grupe për realizimin e orës së përsëritjes.

REZULTATI

Krijimi i një ambienti motivues, ku nxënësi ndihet i lirë të shprehë mendimin e tij dhe të vlerësojë shokët, duke zhvilluar paralelisht aftësi profesionale dhe të buta.

“Si çdo mësues, e kam përparësi gjithëpërfshirjen dhe sidomos të nxënës me në qendër nxënësit. Këto arsye më bëjnë që të jem gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja që të më ndihmojnë në arritjen e këtyre synimeve.”



Realizimi

Në kuadër të punës në grup, sidomos gjatë orës së përsëritjes, mësuese Entela mendoi të aplikojë “Lojën me role”. Për ta realizuar këtë, ajo i beson një nxënësi rolin e mësuesit dhe ajo vetë ndjek mësimin në fund të klasës, duke ndërhyrë vetëm nëse është e nevojshme për ndonjë saktësim të njohurive kur e shih të nevojshme. Nxënësit e tjerë ndahen në tri skuadra. Secila prej skuadrave zgjedh emrin e saj të përfaqësimit, gjithmonë duke përdorur emërtime që lidhen me nocione kyçe të temave të përsëritjes. Për shembull në një orë të përsëritjes në lëndën “Bazat e TIK”, nxënësit zgjedhën që skuadrat e tyre të merrnin emrat e firmave të njohura prodhuese të hardware: Intel, Accer, Apple. Mbi një tavolinë në mes të laboratorit, mësuesja radhiti pjesët hardware që përfshiheshin në temat e përsëritjes. Pasi iudrejtua pyetja, lideri i skuadrës u ngrit dhe mori nga tryeza pajisjen së cilës i referohej pyetja. Në lëndë të tjera, mësuesja përgatiti vetë materialin me pyetjet kyçe dhe nxënësi “mësues” i shfaq në SMARTboard, në mënyrë të njëpasnjëshme, duke ia drejtuar secilës skuadër sipas radhës.

Gjithmonë pyetjet përfshijnë të tria nivelet e përvetësimit të njohurive, pra ka pyetje specifike për nivelin e parë, ku evidentohet

çdo pajisje hardware, pra kontrollohet objektivi bazë, e gjithashtu diskutohen dhe karakteristikat e tij; për nivelin e dytë, mbi ndërtimin e hardware-ve, i cili bazohet në shpjegim të detajuar; për nivelin e tretë, mbështetur në krahasimin midis hardware-ve mbi karakteristikat më të mira, firmat më të njohura prodhuese etj., duke kaluar kështu në një nivel analize dhe nxitjeje të mendimit kritik të nxënësit. Nxënësi “mësues” i drejton pyetjen çdo skuadre, pret me durim përgjigjen nga të gjithë pjesëtarët e skuadrës dhe pranon edhe plotësime nga skuadrat e tjera. Kjo sjell mobilizimin e të gjithëve, disa për të bërë më të mirën për të fituar maksimalen e pikëve, disa që skuadra e tyre të jetë e vëmendshme për të gjetur e shtuar informacion. Të gjithë synojnë të jenë kryesues në tabelën e pikëve, të cilën mësuesja e paraqet në flip chart.

Impakti

Puna në grup, e ardhur në formën e një “Loje me role” të nxënësit, shoqërohet me shumë efekte pozitive tek ata, të cilat mësuese Entela i ndan në këto shtylla kryesore. Së pari, loja me role krijon mundësi për gjithëpërfshirje; të gjithë nxënësit aktivizohen dhe ndjejnë se janë një vlerë e shtuar gjatë orës mësimore. Së dyti, në klasë krijohet një ambient në të cilin nxënësit ndjehen të lirshëm të shprehën, të ndajnë mendimet dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Së treti, në mënyrë të natyrshme, realizohet edhe vlerësimi mes shokëve. Në rrethanat e një loje, ata harrojnë se janë në një orë mësimi dhe nuk ngurojnë të kritikojnë dhe të japin mendimin e tyre. Së katërti, mësuese Entela arrin të shfrytëzojë në mënyrë optimale orën e mësimi. Ajo jo vetëm realizon orën e përsëritjes, por mund të vlerësojë nivelin e përvetësimit të temës nga nxënësit dhe të kuptojë vështirësitë e nxënësve për t’u ardhur më pas në ndihmë. Së fundmi, për mësuese Entelën vlera e shtuar e kësaj forme mësimdhënieje është konsolidimi i aftësive të buta si: komunikimi, bashkëpunimi, artikullimi i ideve, dakordësia, dhënia e feedback-ut tek të tjerët.

Mësimet e nxjerra

Mësuese Entela tregon se në gjithë këto vite të mësimdhënies së saj, nuk i ka ndarë asnjëherë nga njeri-tjetri dy qëllimet e saj kryesore: e para, që nxënësit të marrin njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht dhe e dyta, të gjej rrugën për në zemrën e secilit prej tyre.

Ajo këshillon mësuesit e tjerë të mos kalojnë asnjë orë mësimi pa iu drejtuar secilit prej nxënësve, pa komunikuar e sidomos pa vlerësuar qoftë edhe një fjali të saktë që vjen prej tyre. Për këtë arsye, ajo sugjeron realizimin e një orë mësimore në formën e “Lojës me role”, sepse krijon mundësinë që nxënësit të ndihen më të sigurt në vetvete, më kritikë ndaj përgjigjeve të shokëve, më të lirshëm për t’u shprehur me shokun e tyre “mësues”. Të gjithë nxënësit do të jenë të përfshirë dhe nuk do të stepen të marrin fjalën sa herë qëdo të kenë diçka për të thënë. Nga kjo eksperiencë, ajo ka mësuar se nxënësit mund të jenë konkurrenës dhe bashkëpunues për të arritur më të mirën dhe arrijnë të përvetësojnë aftësinë aq shumë të kërkuar në tregun e punës, atë të punës në grup.

Mësimdhënia tashmë digjitale: Si mund të vijë në ndihmë metoda e klasës së përmbysur

Gjenovefa Xhakaj, Shkolla Tregtare Vlorë



Konteksti dhe nevoja

Në kushtet e pandemisë, në shkollat e mesme profesionale mësimi po zhvillohet online dhe ora mësimore është reduktuar në vetëm 30 minuta. Mësuesit, të gjendur përballë një realiteti të ri, të mbushur me situata të panjohura, gjenden shpesh në vështirësi për të bërë më të mirën gjatë një ore mësimore. Gjetja dhe aplikimi i metodave të duhura të mësimdhënies të cilat të jenë efektive, të mundësojnë shfrytëzimin optimal të orës së mësimi, të rrisin motivimin e nxënësit dhe ndërveprimin, si dhe të nxisin punën e pavarur, është një sfidë e vërtetë. Ndërkohë, aplikimi i metodave jashtë kuadrit tradicional, ku nxënësi vendoset në qendër të procesit mësimor dhe mësuesi luan më tepër rolin e lehtësuesit duke u mbështetur edhe në mësimin e kombinuar, është në fokus të rekomandimeve të studjuesve dhe ekspertëve në mbarë botën.

Mësuese Gjenovefa Xhakaj, për të optimizuar kohën në dizpocion të orës mësimore dhe me dëshirën për të sjellë një qasje ndryshe në procesin e të nxënës, aplikon në një pjesë të orëve mësimore metodën e “klasës së përmbysur”, duke i vendosur paraprakisht nxënësit në pozita pune mbi njohuritë që do të ofrohen në orën e ardhshme.

Nëpërmjet aplikimit të metodës së klasës së përmbysur, siç shpjegon mësuese Gjenovefa, synohet të aplikohet një metodë ndryshe, ku nxënësi i paraprin orën së mësimi duke punuar në mënyrë të pavarur mbi një material (tekst, video, imazh domethënës etj.), të cilin fillimisht përpikët ta kuptojë vetë e më pas ta zbërthejë me ndihmën e mësuesit, gjatë orës së mësimi. Një qasje e tillë ka si qëllim të nxitë edhe aftësitë analitike, interpretuese, vlerësuese dhe kreative të nxënësit, si dhe të rritë ndërveprimin gjatë orës së mësimi, në sajë të diskutimit mbi atë që nxënësit kanë arritur të kuptojnë.



PROBLEMI

Pamjaftueshmëria e orës mësimore për të realizuar në çdo rast një procesi mësimor ndërveprues, me nxënësin në qendër.

ZGJIDHJA

Aplikimi i metodës së “klasës së përmbysur”, ku nxënësit njihen dhe punojnë paraprakisht me një tekst apo veprimtari në mënyrë të pavarur dhe më pas e rimarrin informacionin me ndihmesën e mësuesit.

REZULTATI

Një orë mësimore më efektive, ku nxënësve u krijohet më tepër hapësirë për t'i angazhuar dhe për të ndërvepruar.

Realizimi

Mësuese Gjenovefa shpjegon se aplikimi i “klasës së përmbysur” ka gjithnjë një hap të parë: shqyrtimin e specifikave të temës për të kuptuar nëse është e përshtatshme për një qasje të tillë. Për të gjykuar drejt, mësuesja bazohet në faktin nëse konceptet e dhëna janë tërësisht të reja për nxënësit, si dhe merr në konsideratë shkallën e vështirësisë së informacionit të ri. Pas përcaktimit të një teme si të përshtatshme për të zbatuar “klasën e përmbysur”, mësuesja vlerëson se cila do të ishte forma më efektive për t’i dhënë impuls nxënësit mbi informacionin që do të marrë në vijim në klasë. Sipas mësueses, larmia në realizimin e kësaj metode është e rëndësishme dhe i shërben qëllimit. Ndërkohë, ofrimi i materialeve mësimore në formë digjitale, në platformën MësoVET, e lehtëson dhe e bën më efektiv aplikimin e “klasës së përmbysur”.

Shpeshherë, mësuesja i fton nxënësit të lexojnë tekstin e përfshirë në çështjen që do të zhvillohet në orën pasardhëse. Nxënësit, në mënyrë të pavarur, në një kohë të përshtatshme për ta, njihen me tekstin nëpërmjet platformës dhe në varësi të kërkesës së dhënë nga mësuesja, mund të nxjerrin pikat kryesore të tij, të identifikojnë konceptet në të cilat hasin më shumë vështirësi, të realizojnë skema sintetizuese mbi informacionin e marrë etj. “Klasa e përmbysur” aplikohet nga mësuesja edhe nëpërmjet videove të ngarkuara në platformë. Nxënësit, në kohën e zgjedhur prej tyre, ndjekin videon, mund t’i rikthehen për ta kuptuar më mirë dhe realizojnë një përmbledhje të informacionit që ajo përmban, ndërkohë që njohuritë më të thelluara i marrin nga mësuesja. Po ashtu, realizohet edhe nëpërmjet një fotoje ngacmuese për mësimin pasardhës, mbi të cilën ngrihet një diskutim në orën vijuese.

Natyrisht, mbështetja në “klasën e përmbysur” është sfiduese. Sa të gatshëm do të jenë nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, duke testuar dhe vlerësuar veten e tyre, duke ditur që gjithsesi informacioni i ri do të përcillet tek ata i plotë në orën e ardhshme të mësimi? Në cilën formë duhet të ofrohet tek ata ky informacion për t’i motivuar? Këto janë pyetjet që mësuese Gjenovefa i shtron vazhdimisht vetes, në përpjekje për të garantuar efektivitet sa më të lartë të kësaj forme të nxëni.



“Mund t’u kërkohet të shohin një foto në platformë me produkte të dëmtuara që mbërrijnë në ndërmarrje dhe nxënësit reflektojnë mbi arsyet e kthimit të produkteve. Të nesërmen, e diskutojmë më konkretisht dhe nxënësit japin argumente. Një foto i ngacmon, u jep ide, i nxit disi.”

Impakti

Mbështetja e procesit mësimor në “klasën e përmbysur”, siç pohon mësuese Gjenovefa, ka një sërë përfitimesh, si në raport me kohën që nxënësit i kushtojnë të nxëni jashtë orës së mësimi, ashtu edhe me vetë ndërtimin e orës së mësimi. Nxënësit mësojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe kuptojnë rëndësinë e saj, duke kultivuar më mirë edhe mënyrën e të nxëni nëpërmjet shqyrtimit, reflektimit, analizës, sintetizimit etj. Kjo rrit motivimin e nxënësve për ta shtrirë procesin e përvetësimit të njohurive përtej orës mësimore, siç ndodh në mjaft raste.

Me sigurinë dhe lehtësimin që i jep fakti se gjithçka do të rimerret gjatë orës së mësimi, nxënësi e konsideron të nxëni si më të thjeshtë, gati-gati si një lojë që nis nga vetë ai në celularin apo kompjuterin e tij dhe që përfundon në orën e mësimi, duke u ndihmuar nga mësuesi. Përfshirja e teknologjisë është padyshim favorizuese në mënyrën se si nxënësit e perceptojnë këtë proces. Paralelisht, impakti pozitiv ndihet edhe gjatë orës së mësimi, e cila shfrytëzohet gjerësisht për të diskutuar mes mësueses dhe nxënësve mbi pikat kyçe të tekstit apo përmbajtjen e videos ose fotos, mbi konceptet ku nxënësit kanë hasur më shumë vështirësi, nevojat për përmirësim etj. Ora mësimore vjen kështu në një format më ndërveprues, duke nxitur shprehjen e mendimit kritik dhe atij kreativ, ndërkohë që konsolidohet edhe forca e argumentit. Një qasje e tillë bën që të nxëni në sytë e nxënësve të jetë një proces natyral, i pandërprerë, që mund të realizohet në çdo formë dhe që nuk njeh kufizim kohor dhe hapësior.

“Kur ne mjaftohemi në çdo rast vetëm me shpjegimin, edhe nxënësi këtë do të bëjë, do të mjaftohet vetëm me shpjegimin dhe shpesh nuk nxitet të punojë në mënyrë të pavarur. Kjo është një nga mënyrat më të mira për ta nxitur dhe motivuar nxënësin.”

Mësimet e nxjerra

Mësuese Gjenovefa dëshmon se aplikimi i “klasës së përmbysur” kërkon gjithnjë një plan B, pra një skenar rezervë të realizimit të orës së mësimit. Sipas saj, pavarësisht se mund ta programosh orënnë detaje, jo gjithnjë mund të kesh sigurinë se do të shkojë sipas planit, pasi gjithçka varet nga puna e pavarur e nxënësve dhe nga shkalla e të kuptuarit të materialit nga ana e tyre. Mësuesja sugjeron të tregohemi fleksibël dhe të shkathët për të ndryshuar strategji. Gjithashtu, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përzgjedhjes së temave apo çështjeve në të cilat “klasa e përmbysur” mund të rezultojë efektive, ndaj mësuesi duhet të përdorë intuitën e tij dhe të mbështetet edhe në nivelin e nxënësve për të kuptuar se ku mund ta aplikojë me sukses këtë metodë.



Një kulturë e re e të nxënësve: përdorimi i Smartboard në procesin mësimor

Alda Palla, Shkolla "Salih Çeka", Elbasan



Konteksti dhe nevoja

Edukimi në ditët e sotme ndodhet disi në udhëkryq. Shumë mësues hasin vështirësi të përçojnë te nxënësit njohuri duke përdorur metoda tradicionale dhe teknologji tashmë të vjetëruara. Nxënësit ndërkohë janë rritur në një botë "të zgjuar", me akses të vazhdueshëm në teknologji dhe shërbime digjitale dinamike. Si rrjedhojë, është e vështirë që ata të tërhiqen nga një shkumës dhe një dërrasë e zezë. Zhvillimi i teknologjisë i ka ardhur në ndihmë edukimit, duke bërë të mundur realizimin e një ore mësimore sa më efikente dhe produktive nëpërmjet përdorimit të pajisjeve "të zgjuara" (smart) në klasë. Një nga këto është edhe SMARTBoard-i, një projektor interaktiv që shfaq outpute të kompjuterit apo pajisjes me të cilën lidhet. Zhvillimi i mësimin në klasa tradicionale ku këto pajisje mungojnë, bëjnë që mësuesit të hasin vështirësi, si: pamundësi për të prezantuar një informacion të ri tek nxënësit duke u kufizuar në atë që ofron shpjegimi në dërrasë të zezë; humbja e interesit nga ana e nxënësve gjatë procesit të shpjegimit tradicional; mungesa e ndërveprimit dhe e gjithëpërfshirjes, etj.

Fatmirësisht, në shkollën "Salih Çeka" në Elbasan, laborator i TIK ku mësuese Alda Palla jep mësim, është i pajisur me SMARTBoard. Si mësuese në drejtimin TIK, nevoja për të prezantuar informacionin e ri në mënyrë sa më tërheqëse për nxënësit e saj, e ka shtyrë të përdorë SMARTBoard-in pothuajse në çdo orë.

Synimi kryesor i kësaj nisme është rritja e cilësisë së një ore mësimore, si dhe kthimi i saj nga një orë tradicionale në një orë më interaktive e më tërheqëse për nxënësit.

"Sot ekzistojnë shumë teknologji të reja që u vijnë në ndihmë si mësuesve edhe nxënësve për të dhënë apo marrë maksimumin gjatë një ore mësimore."



PROBLEMI

Nxënës që rriten në një botë "të zgjuar", me pak interes ndaj formave tradicionale të mësimdhënies dhe teknologjive tashmë të vjetëruara.

ZGJIDHJA

Shfrytëzimi i pajisjeve "të zgjuara" në klasë (SMARTBoard) për një proces mësimor interaktiv.

REZULTATI

Përmirësimi i metodave me në qendër nxënësin, rritje e kreativitetit, e përqëndrimit dhe e motivimit.

Realizimi

Përdorimi i një SMARTBoard-i në klasë është shumë i thjeshtë, mjafton të kesh burimet e duhura. Ai funksionon me kombinimin e dërrasës së bardhë (whiteboard) interaktive, një kompjuter, projektor, si dhe software-i i SMARTBoard. Pasi montohet në mur, lidhet me kompjuterin ose laptopin nëpërmjet një ose disa kablove usb. Përpara se ta përdorim, duhet të instalojmë disa drivera: SMARTBoard-i vjen me një disk, i cili është shumë i thjeshtë për t'u instaluar nga të gjithë. Vetëm në këtë mënyrë mund të shkruajmë, të bëjmë shënime mbi ekran dhe të kemi interaktivitet me të.

Sigurisht, që një mësues të punojë me SMARTBoard, duhet të ketë njohuri bazike mbi përdorimin e kompjuterave. Më pas, në mund të shohë video tutoriale në Youtube që shpjegojnë se



Impakti

Teknologjia ka transformuar mënyrën e mësimdhënies dhe të nxënësve. Duke transformuar procesin, ajo po transformon edhe rezultatin. Përdorimi i SMARTBoard-it në klasë ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve, pasi ata ndjehen më të motivuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Përpos këtyre:

- SMARTBoard-i e bën nxënësin më të interesuar për temën mësimore
- shkurton kohën e të nxënësve ofron mundësi për të realizuar mësimin në mënyrë jotradicionale
- rrit motivimin dhe përqendrimin e nxënësve
- ndihmon në përthithjen më të mirë të informacionit
- nxit kreativitetin
- ndihmon nxënësit me aftësi të ndryshme konceptuale, si dhe nxënësit me nevojë të veçanta, në përthithjen më të shpejtë të koncepteve të reja

Krahas nxënësve, përfitues janë edhe mësuesit, të cilët kanë mundësi të integrojnë metoda alternative në një orë mësimore. Nxënësit mësojnë duke parë, duke dëgjuar dhe duke ndërpëruar me tabelën nëpërmjet prekjes (touch screen). Kjo gjë, i krijon mundësinë mësuesve të jenë kreativë dhe novatorë gjatë përcjelljes së njohurive. Mësuesit e kanë më të lehtë dhe më të shpejtë procesin e përcimit të informacionit të nxënësve, duke mos i mërzhitur ata. Opsioni i prekjes i lejon mësuesit të lundrojnë më shpejt në përmbajtje, si dhe të shtojnë shënime gjatë shpjegimit. Gjithashtu, SMARTBoard bën të mundur kombinimin e pjesës teorike me multimedien, duke lënë gjurmë më të thella të nxënësve.

“Kënaqësia ime më e madhe është rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe e të nxënësve.”

Mësimet e nxjerra dhe këshilla për ta replikuar

Duke përdorur së bashku teknologjinë dhe qasjen konstruktive, mësuesi siguron integrim dhe shfrytëzim më të mirë të mjeteve të teknologjisë në klasë, në mënyrë të përshtatshme dhe efektive, duke i dhënë procesit mësimor mjetin e nevojshëm për të përmirësuar metodat me në qendër nxënësin. Gjatë punës me SMARTBoard, mësuesi arrin të mësojë të gjithë funksionalitetet e kësaj pajisjeje, të përvetësojë përdorimin e saj dhe ta integrojë në formë të ndryshme. Gjatë këtij procesi, krahas mësuesit mëson edhe nxënësi rreth teknologjive të reja dhe qasjes me to. Mësuese Alda shpreh bindjen se përfshirja e teknologjisë në klasë do të ishte edhe më efektive nëse do të krijoheshin mundësi të përdorësh nga të gjithë mësuesit. Kjo nuk vlen vetëm për mësuesit e drejtimit TIK, por edhe të lëndëve të tjera. Ekzistojnë shumë software që mund të shkarkohen falas dhe mund të integrohen me SMARTBoard-in në varesi të lëndës. Ka shumë forume dhe website që ndihmojnë mësuesit me aktivitete të ndryshme që mund të zhvillojnë me ndihmën e SMARTBoard, siç ka edhe shumë video në youtube që shpjegojnë në mënyrë të detajuar përdorimin e saj. Ka shumë mënyra se si mësuesit mund ta përdorin SMART Board-in në klasë, pasi shoqërohet me opsione të ndryshme, si ai i kamerës, vizatimit, ndarjes së ekranit etj. Opsioni i kamerës të lejon të bësh një fotografi të ekranit bashkë me shënime të bëra gjatë leksionit dhe ta vazhdojë atë herë tjetër pikërisht aty ku e ke lënë. Opsioni i vizatimit lejon që të bësh shënime ndihmëse në ekran gjatë shpjegimit. Opsioni i ndarjes së ekranit të lejon të mbash dy ekrane paralele, ku për shembull mësuesi në njërin ekran mban kërkesën e një ushtrimi të caktuar dhe në anën tjetër shkruan zgjidhjen e tij. Mësuese Alda sugjeron eksplorimin e të gjitha opsioneve për t'ia përshtatur sa më mirë specifikave të lëndës dhe vizionit të mësuesit për organizimin e orës së mësimi.

Projektet ndërlëndore: konceptet në lëndën e matematikës bëhen interesante

Ardita Uka, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë



Konteksti dhe nevoja

Arsimi profesional në Shqipëri është në zhvillim të vazhdueshëm, si në drejtim të fushave në të cilat shtrihet, ashtu edhe nga pikëpamja kurrikulare. Kurrikula e re i mëshon fort krijimit të lidhjeve mes lëndëve të ndryshme, të quajtura lidhje ndërlëndore. Falë identifikimit të urave lidhëse mes lëndëve të ndryshme, nxënësi arrin të zhvillojë më mirë kompetencat e secilës lëndë dhe ato kyçe, si dhe të kuptojë më mirë ndërvarësinë që ekziston mes fushave të ndryshme, si në teori ashtu edhe në praktikë. Nëpërmjet projekteve ndërlëndore, sidomos në ato të zhvilluara mes një lënde profesionale dhe një tjetre të përgjithshme, nxënësi arrin të vlerësojë më mirë rëndësinë e secilës lëndë si dhe të përvetësojë në mënyrë më efektive njohuritë përkatëse.

Në shkollën Teknike Ekonomike Tiranë, Ardita Uka, mësuese në lëndën e Matematikës në drejtimin Ekonomi - Biznes, është ndeshur vazhdimisht me një interes jo të kënaqshëm nga ana e një pjese të nxënësve mbi lëndën e Matematikës, si për shkak të qëndrimit skeptik nga ana e nxënësve mbi lëndët e përgjithshme në tërësi, ashtu edhe si rrjedhojë e vështirësive që ata ndeshin në përvetësimin e njohurive të kësaj lënde. Nisur edhe nga theksi që kurrikula e re vendos mbi integrimin lëndor, **mësuese Ardita ka përzgjedhur të realizojë herë pas here projekte ndërlëndore që lidhin Matematikën me lëndë të Ekonomisë. Synimi kryesor i saj është që të rrisë te nxënësit interesin dhe shkallën e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e lëndës së Matematikës, falë pikave të takimit dhe ndërvarësive të kësaj lëndë me fushën për të cilën ata po përgatiten profesionalisht.**

SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

PROBLEMI

Oëndrimit skeptik i nxënësve dhe vështirësi në përvetësimin e njohurive të lëndës së Matematikës.

ZGJIDHJA

Realizimi i projekteve ndërlëndore, nëpërmjet të cilëve nxënësi eksploron pikat e takimit të koncepteve të marra në lëndën e Matematikës me fushën për të cilën ata po përgatiten profesionalisht.

REZULTATI

Nxënës me interes për të përvetësuar njohuritë në lëndën e Matematikës dhe të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e saj në fushën ku ata studiojnë.



Realizimi

Nisma të tilla të ndërlidhjes mes lëndëve, mësuesja ka nisur t'i realizojë që në fillim të zbatimit të kurrikulës së re. Hapi i parë në zhvillimin e projekteve ndërlëndore është përcaktimi i lëndës me të cilën do të realizohet lidhja. Më pas, mësuese Ardita kontakton me mësueset e lëndëve përkatëse, duke u konsultuar me to mbi tematikën e projektit lëndor dhe mbi pikat konkrete të takimit mes lëndëve. Mësuesja i realizon projektet ndërlëndore në formën e punës në grup. Pasi përcaktohet tema për të cilën nxënësit do të punojnë, ndahen edhe detyrat brenda grupit. Një ndër projektet që mësuese Ardita veçon si një prej më të preferuarat për nxënësit është ai i lidhjes me fushën e Llogarisë, duke synuar nxjerrjen në pah të lidhjes mes derivateve, maksimit të fitimit dhe kostove marxhinale në kontekstin e shitjes së një produkti konkret. Pasi nxënësit punuan në grup për të nxjerrë në pah lidhjet mes këtyre elementeve, u realizua prezantimi i projekteve në klasë. Një element i rëndësishëm i fazës së prezantimit është diskutimi i realizuar nga vetë nxënësit mbi punimet e secilit grup. Mësuese Ardita në këtë fazë e vendos veten në një rol dytësor, duke i lënë nxënësit të lirë në vlerësimin që ata i bëjnë punës së njëri-tjetrit dhe duke ndërhyrë vetëm kur e shih të nevojshme ndonjë koment nga ana e saj për të zhvilluar mendimin kritik. Sfida në realizimin e projekteve të tilla qëndron në përzgjedhjen e lëndës me të cilën do të realizohet ndërlidhja si dhe të tematikës, por nëpërmjet bashkëpunimit të duhur me mësuesit e lëndëve të tjerave dhe të kuptuarit të interesave dhe të nevojave të nxënësve, mësuesja e kapërcen me lehtësi. Njëkohësisht, vështirësitë që hasin nxënësit në përvetësimin e koncepteve të reja në Matematikë thjeshtohet nëpërmjet ndërtimit të orës së mësimit mbi bazë projekti, si dhe të punuarit në grup.

Impakti

Nëpërmjet qasjes ndërlëndore, nxënësit kuptojnë më mirë të pikat e takimit mes tyre, duke e perceptuar procesin e të nxëniti jo si një shumë mekanike njohurish të lëndëve të ndryshme, të fragmentuara, por si një sistem të mirëintegruar dhe të harmonizuar. Të tilla qasje ndikojnë pozitivisht edhe në mënyrën se si nxënësit i konsiderojnë lëndët e përgjithshme, ndërkohë që kanë zgjedhur shkollimin profesional. Këto lëndë bëhen më të vlefshme në sytë e tyre, ndaj edhe interesi për t'i përvetësuar ato është më i lartë. Një ndër efektet pozitive kryesore qëndron në mënyrën se si nxënësit e një shkolle profesionale i perceptojnë lëndët e përgjithshme, pasi ata i shohin më në funksion të aftësimit të tyre profesional, duke u përgatitur më mirë për tregun e punës. Në të njëjtën kohë, realizimi dhe prezantimi i projekteve të tilla ndërlëndore thyen edhe monotoninë e orës mësimore, duke iu ofruar nxënësve një mënyrë ndryshe të të nxëniti. Në këtë mënyrë, nxënësit janë më të nxitur dhe më produktivë. Evidentimi i lidhjeve mes lëndëve dhe fushave në tërësi nëpërmjet projekteve që ata vetë realizojnë, i bën nxënësit më entuziastë ndaj procesit të të nxëniti, si dhe forcon vetëbesimin e tyre. Të gjithë nxënësit ndihen të përfshirë, më të lirë për t'u shprehur, madje gjatë prezantimit kanë arritur të shkëlqejnë edhe nxënës që përgjithësisht janë më pak performantë e më të tërhequr.

Sipas mësuese Ardites, realizimi i projekteve të tilla shoqërohet edhe me zhvillimin e aftësive të buta tek nxënësit. Ajo shih tek ata aftësi më të mira komunikuese e bashkëpunuese. Nxënësit janë gjithmonë e më të hapur ndaj ideve të reja dhe debatit konstruktiv. Mësuese Ardita thekson se krahas nxënësve, zhvillimi i projekteve ndërlëndore ka efekt pozitiv edhe tek ajo vetë. Njohja më e mirë e lëndëve ekonomike i mundëson mësueses ta orientojë më mirë lëndën e saj dhe veprimtaritë e realizuara gjatë orës së mësimit (ushtrime, raste studimi etj.) drejt fushës së Ekonomisë.

Mësimet e nxjerra

Gjatë realizimit të projekteve ndërlëndore, mësuese Ardita ka kuptuar në radhë të parë se gjithçka që realizohet në mënyrë praktike ka më shumë vlerë në sytë e nxënësit, është më lehtësisht e përthithshme dhe lë më shumë gjurmë tek ta. Mësuese Ardita u sugjeron të gjitha mësuesve, veçanërisht atyre të lëndëve të përgjithshme, të përqëndrojnë vëmendjen dhe përpjekjet e tyre në realizimin e projekteve të tilla ndërlëndore. Ato janë një formë efikase e transferimit të njohurive tek nxënësi nëpërmjet krijimit të hapësirave më të mëdha për punë të pavarur e ndërveprim, si dhe një mënyrë për t'i ndërgjegjësuar mbi vlerën e lëndëve të përgjithshme, si në drejtim të formimit të tyre profesional ashtu edhe në fitimin e kompetencave të vlefshme për jetën.

“Impakti kryesor i projekteve ndërlëndore qëndron në mënyrën se si nxënësit e një shkolle profesionale i perceptojnë lëndët e përgjithshme, pasi ata nisin t'i shohin më tepër në funksion të aftësimit të tyre profesional, duke u përgatitur më mirë edhe për tregun e punës.”



Aktivitetet jashtëkurrikulare si një formë alternative e të nxënësve

Adriana Prenga, Shkolla "Kolin Gjoka", Lezhë



Konteksti dhe nevoja

Perceptimi i mësuesve dhe nxënësve mbi orën mësimore po ndryshon vazhdimisht. Tashmë ora mësimore nuk përfaqëson më thjesht një "dritare" kohe brenda një klase fizike, të cilën mësuesi e shfrytëzon për riprodhuar dhe përcjellë njohuri teorike në mënyrë mekanike dhe shabllon te nxënësit. Gjithnjë e më shumë, ora po diversifikohet nga pikëpamja e organizimit të saj dhe veprimtaritë të përfshira në të po orientohen drejt aspekteve praktike, të konkretizimit të njohurive të marra, të cilat janë edhe më tërheqëse dhe mbështesin të nxënësve aktiv.

Në shkollën "Kolin Gjoka", në drejtimin Hoteleri-Turizëm, mësuese Adriana Prenga ka ndjerë prej kohësh nevojën për të sjellë risi në procesin mësimor, me qëllimin për të ndërthurur vënien në praktikë të njohurive teorike me gjallërinë dhe motivimin që këto risi sjellin te nxënësit. Një ndër këto veprimtari janë edhe aktivitetet jashtëkurrikulare të ardhura në formën e konkurseve. **Vënia në jetë e nismave të tilla synon konsolidimin e aftësive dhe krijimin e shprehive të nxënësve nëpërmjet mundësisë të praktikimit të njohurive të fituara në teori, paralelisht me angazhimin dhe motivimin e tyre nëpërmjet një forme alternative të nxënësve.**

Realizimi

Një ndër veprimtaritë interesante të zhvilluara nga mësuese Adriana ishte ajo e sjellë në kuadër të periudhës së praktikave profesionale gjatë pandemisë, të cilat nuk mund të realizoheshin pranë bizneseve. Mësueses i lindi ideja që nxënësit të praktikoheshin në kushtet e shtëpisë. Nën titullin tërheqës "Unë gatuj recetën e gjyshes" secili nxënësdo të realizonte një gatim sipas mundësive dhe me përbërësit që kishte në dispozicion. Nxënësit do të filmonin ose fotografonin hapat e recetës, duke dokumentuar kështu praktikën profesionale të sjellë në një formë ndryshe. Gradualisht, ideja evoluoi drejt zhvillimit të një konkursi bazuar në recetat më të mira të përgatitura nga nxënësit. Me ndihmën e shef Alfred Markut, instruktor i nxënësve që zhvillojnë praktikën në restorant "Rapsodia", dhe shef Arbërit nga restorant



PROBLEMI

Njëtrajtshmëria e orës mësimore, e mbështetur kryesisht në veprimtari tradicionale dhe në qasje teorike, me impakt të ulët motivues dhe angazhues.

ZGJIDHJA

Realizimi i konkurseve mes nxënësve, si një veprimtari ndryshe në procesin e të nxënësve.

REZULTATI

Mundësi më të mëdha praktikimi të njohurive të përfutuara në teori, krijim shprehish pune, nxitje e kreativitetit dhe rritje e movimit.

“Jolly”, u zhvillua konkursi ku u realizuan rreth 30 receta gatimi. Konkursi shërbeu si për të vlerësuar nga ana teknike përgatitjen e recetave, ashtu edhe për të shqyrtuar aspektin kurrikular për përbushjen e rezultateve mësimore sipas modulit.

Një tjetër konkurs i ideuar nga ana e mësuese Adrianës ishte ai në kuadër të lëndës Estetikë dhe Marketing. Vështirësia dhe pamjaftueshmëria për të trajtuar vetëm në plan teorik një prej temave, atë të lidhur me sistemin e pjatancave në bufe, e shtyu mësuesen të organizonte një minikonkurs mes disa prej nxënësve të dy klasave paralele. Nxënësit ndanë fillimisht detyrat dhe rolet, ku grupi i parë do të blinte produktet e nevojshme, grupi i dytë do të organizonte klasën për konkursin, ndërsa i treti do të ndiqte konkurentët dhe do t'u drejtonte pyetje. Secila klasë kishte drejtuesin e saj, i cili do të organizonte punën dhe do të menaxhonte grupin. Konkursi u shtri gjatë tri orëve mësimore dhe grupet realizuan dy dekorime të pjatancave të ndryshme, mbi të cilat u zhvillua edhe një diskutim.


Mësuese Adriana pranon se realizimi i nismave të tilla ndeshet edhe me vështirësi, si në aspektin e formalizimit të tyre, ashtu edhe në atë aplikativ. Kërkohet punë paraprake për ta paraqitur idenë në formë projekti, duke plotësuar një sërë dokumentesh justifikuese për t'u dorëzuar në drejtori, ku duhet të evidentohet konteksti në të cilin veprimtaria do të zhvillohet dhe mënyra e realizimit të saj, si dhe të argumentohet impakti në të nxënë. Zhvillimi i konkurseve kërkon gjithashtu kohë dhe përkushtim, si nga ana e mësuesve, ashtu edhe e nxënësve. Në rastin e realizimit të konkurseve në kushtet e shkollës, mungesa e kuzhinës dhe nevoja për financim për blerjen e produkteve janë po ashtu sfiduese. Nevojitet praktikim në bizneset ku zhvillohet praktika profesionale dhe kjo përbën një sfidë për mësuese Adrianën, e cila duhet t'i ndjekë nga afër nxënësit që përgatiten për konkurs. Nga ana tjetër, mosha e re e nxënësve, euforia që shfaqin apo krijimi i situatave të papritura kërkojnë një menaxhim të kujdesshëm. Mësuesja pohon se sfida të tilla janë të pashmangshme, por stafi bashkëpunues dhe dëshira e madhe e nxënësve për të marrë pjesë në të tilla veprimtari, e ndihmojnë t'i kapërcejë dhe e motivojnë vazhdimisht.

Impakti

Mësuese Adriana shpjegon se veprimtari të tilla i përgjigjen jo vetëm nevojës për të vënë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e përcjella nëpërmjet teorisë, por edhe asaj për një “rifreskim” të procesit mësimor. Nxënësit ndihen më të lirshëm, jashtë kornizave të orës tipike të mësimi. Ata tërhiqen nga veprimtari të tilla, ku nuk ndjejnë presionin e zakonshëm të orës së mësimi. Shkëputja që krijohet dhe dalja nga monotonia zhvillon te nxënësit mendimin krijues dhe i bën më aktivë më të guximshëm. Angazhohet edhe ajo pjesë pasive e nxënësve, të cilët, ndonëse në teori mund të mos kenë shfaqur nivelin e duhur – ndonjëherë edhe për shkak të natyrës së ndrojtur të tyre – kanë demonstruar në praktikë se kanë krijuar shprehitë e duhura të punës. Gjatë konkurseve, nxitet edhe konkurrenca mes nxënësve, të cilët motivohen të

shfaqin më të mirën e tyre. Prania dhe vlerësimi i dhënë nga shefat e kuzhinës është një tjetër element motivues për nxënësit, por me përfitime edhe për mësuesit, të cilët përditësojnë dhe pasurojnë njohuritë e tyre. Po ashtu, nxënësit kanë mundësi të konsolidojnë aftësitë e tyre të buta si: menaxhimi i kohës, marrja e përgjegjësi, komunikimi, puna në grup etj. Njëkohësisht, mundësia për të shfaqur në praktikë njohuritë e marra në teori ndihmon edhe mësuesit për të kuptuar më mirë progresin e nxënësve dhe për t'i vlerësuar sa më objektivisht.

“Nxënësit i përqafojnë nismat e reja. Mjafton t'i nxitësh, të mos t'ua vësh si kusht dhe të mos ua prezantosh idenë si mjet vlerësimi, por t'u krijosh hapësirë për të ndjerë se po marrin pjesë me dëshirën e tyre.”



Mësimet e nxjerra dhe këshillat për ta replikuar

Nga realizimi i konkurseve të tilla, mësuese Adriana ka kuptuar mbi të gjitha se në fusha si ajo e kuzhinës, pavarësisht përpjekjeve të mësuesit për të përcjellë siç duhet njohuritë teorike, fitimi i shprehive nëpërmjet praktikës është thelbësor. Veprimtari të tilla i kanë treguar asaj se nxënës të cilët mund të shfaqen pasivë në kuadër të teorisë, mund të të surprizojnë kur u jepet mundësia për t'u praktikuar. Njëkohësisht, mësuesja është ndërgjegjësuar më tej mbi nevojën që nxënësit dhe procesi i formimit të tyre ka për nisma të tilla të reja, ku nxënësi praktikohet, përvetëson dhe njëkohësisht argëtohet. Mësuesja sugjeron që veprimtari të tilla, ndonëse impenjative, të organizohen vazhdimisht, duke u konsultuar paraprakisht edhe me nxënësit. Diskutimi me ta për të kuptuar më mirë mangësitë e tyre, nevojat dhe interesat është një fillim i mbarë. E rëndësishme është të lindë ideja dhe të ekzistojë dëshira nga të dyja palët.

Një mënyrë e re e shfrytëzimit të platformës MësoVet: Portofoli elektronik

Lorena Gjonçaj, Shkolla Tregtare Vlorë



Konteksti dhe nevoja

Në Shqipëri, teknologjia në mësimdhënie dhe të nxënëskut ka qenë e integruar në procesin mësimor deri vonë, sidomos në kontekstin e arsimit profesional. Kjo për shkak të mungesës së infrastrukturës, të aftësive digjitale të nxënësit dhe mësuesit, si dhe mungesës së iniciativës nga këta të fundit për të eksperimentuar në metoda alternative të mësimdhënies, ku teknologjia është mbështetësja kryesore. Përfshirja e teknologjisë në procesin mësimor jo vetëm rrit produktivitetin, por ka ndikim pozitiv në mënyrën e komunikimit dhe bashkëpunimit me nxënësit, në përmbytjen e materialit, si dhe në të nxënësit e pavarur dhe të personalizuar.

Në fillimin e vitit shkollor 2019-2020, me mbështetjen e projektit "Aftësi për Punë" në shkollën Tregtare Vlorë filloi prezantimi dhe trajnimi i mësuesve për platformën MësoVET, në kuadër të aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies. E dizenuar për të ndihmuar mësimdhënësit të krijojnë kurset e tyre të personalizuar online, kjo platformë mundëson një mori funksionalitetesh dhe opsionesh për ta sjellë materialin mësimor dhe orën mësimore në një formë ndërvepruese dhe angazhuese. Nisur ngakëto avantazhe, Lorena Gjonçaj, mësuese në këtë shkollë, vendosi ta përdorë platformën në funksion të lëndës së Matematikës.

Me qëllim krijimin e një databaze që do të shmangte mbingarkesën nga dorëzimet me shkrim të portofoleve të nxënësve, ndarjen e informacionit të aksesueshëm në çdo kohë, nxitjen e motivimit dhe angazhimit të nxënësve, si dhe realizimin e një procesi mësimor sa më të produktiv, mësuese Lori solli një inovacion: krijimin e portofoleve elektronik në platformën MësoVET.



PROBLEMI

Portofole të mbingarkuara me detyra në fletë të nxënësve dhe një proces ku mungonte interaktiviteti dhe kreativiteti.

ZGJIDHJA

Përdorimi i platformës MësoVET në krijimin e portofoleve elektronike, si një alternativë për nxënësit dhe mundësi për rritjen e angazhimit të tyre.

REZULTATI

Realizimi i një procesi efektiv në zhvillimin dhe vlerësimin e portofoleve, rritja e angazhimit dhe motivimit tek nxënësit dhe zhvillimi i aftësive digjitale.

Realizimi

Gjithçka nisi me krijimin e kursit të lëndës “Matematika 10” në platformë. Ky kurs u personalizua sipas nevojave dhe objektivave që mësuese Lorena ka në realizimin e një ore mësimore, duke e pasuruar me mematerial teorik, ushtrime dhe kuice. Duke përvetësuar përdorimin e platformës dhe duke testuar funksionalitete të ndryshme, mësuesja vendosi të shfrytëzojë këtë mundësi edhe në procesin e realizimit të detyrave të 3-mujorit të nxënësve online, duke asistuar kështu në plotësimin e portofoleve të tyre. Fillimisht, mësuesja shkarkoi në platformë Standardin e Vlerësimit, një dokument i ndarë në rubrika me detyrat përkatëse, afatet e dorëzimit dhe pikët e vlerësimit. Në këtë mënyrë, çdo muaj nxënësit kishin mundësinë të shihnin detyrat, llojin, mënyrën e vlerësimit dhe pikët e marra, duke evituar kohën e shpenzuar për shpjegim nga ana e mësuesit. Si çdo fillim viti, mësuese Lori bëri prezantimin e këtij dokumenti në klasë, por këtë herë nëpërmjet platformës MësoVET. Një ndihmëse e madhe në këtë proces ka qenë edhe shfrytëzimi i lëndës “Bazat e TIK”, ku nxënësit mund të punonin individualisht në kompjuterat e laboratorit të informatikës për të përvetësuar përdorimin e platformës online. Vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit të platformës edhe nëpërmjet telefonit, duke qenë se shumë pak nxënës kishin një kompjuter në shtëpi. Për të përmirësuar procesin dhe për të kuptuar nëse nxënësit e kanë përqafuar këtë nismë, mësuese Lori realizoi edhe një anketë, ku ata u pyetën rreth përdorimit të platformës online dhe vështirësive.

Krijimi i portofoleve elektronike, si një iniciativë e re si për mësuese Lorenën dhe për nxënësit, kërkoi përkushtim dhe kohë nga të dyja palët. Megjithatë, në momentin kur nxënësi arrin të perceptojë përdorimin e platformës në funksion të ndërtimit të portofoleve të tyre, të gjitha proceset e tjera janë lehtësisht të realizueshme dhe eficiente. Nxënësit i krijohet mundësia të dorëzojë detyrat në formate të ndryshme, si PowerPoint, imazhe, video, duke krijuar kështu një portofol të larmishëm, si dhe të diskutojë në forum. Dorëzimi i detyrave mund të bëhet në çdo moment të përshtatshëm për ta; nga ana tjetër mësuesja ka mundësi të japë vlerësimin në kohë, duke e patur këtë të fundit të dokumentuar si për vete edhe për nxënësin. Një sfidë gjatë procesit ka qenë niveli i ulët i aftësive digjitale të nxënësve, por ndihma e vazhdueshme e mësuese Lorenës dhe kurioziteti i tyre i bëri të përparonin me ritme të shpejta.



Impakti

Fakti që mësuese Lorena i kushtoi disa orë mësimore procesit të krijimit të portofoleve ndikoi pozitivisht te nxënësit. U zhvillua fryma e bashkëpunimit dhe e ndarjes së eksperiencave me njëritjetrit. Shpeshherë mësuese Lori vendosej në rolin e lehtësueses në këtë proces, duke vendosur në qendër nxënësit me aftësi të mira digjitale të cilët iu vinin në ndihmë të tjerëve, duke iu mësuar jo vetëm përdorimin e platformës por edhe burime të informacionit online, video, aplikacione dhe forma prezantimi. Duke parë punët e njëritjetrit, nxënësit u bënë ambiciozë për të dhënë më të mirën. Ora e mësimit, si në klasë edhe online, u bë më tërheqëse dhe më interaktive. Nxënësit zhvilluan sensin e tyre kreativ në përgatitjen e detyrave dhe rrjedhimisht, rezultatet ishin të mira. Kjo iniciativë i ndihmoi nxënësit të ishin të përgatitur edhe gjatë periudhës së mësimit online për shkak të pandemisë. Ata nuk hasën vështirësi, duke qenë se kishin zhvilluar aftësitë e duhura digjitale për realizimin me sukses të mësimit në distancë dhe të portofoleve të tyre.

Mësimet e nxjerra

Që nga momenti i njohjes me platformën MësoVET, perceptimi i mësuese Lorenës mbi përdorimin e teknologjisë në të mirë të mësimdhënies dhe të të nxënësit ka ndryshuar shumë. Ajo ka kuptuar se fleksibiliteti që platforma të tilla krijojnë, si për mësuesin dhe për nxënësin, larmishmëria në mënyrën se si materialet prezantohen dhe rritja e produktivitetit janë aspekte që duhen shfrytëzuar. Sipas mësueses, edhe pse për lëndë si ajo e Matematikës, interesi i nxënësit mund të jetë i ulët, kombinimi me teknologjinë e bën lëndën më angazhuese, më argëtuese dhe, për rrjedhojë, më të lehtë për t'u përvetësuar. Mësuesja sugjeron që t'i jepet më shumë rëndësi njohjes me platformat online dhe aftësimin të tyre në përdorim, si nga ana e mësuesve, ashtu edhe nga nxënësit, për realizimin e një procesi mësimor efektiv dhe për të arritur objektivat mësimore.

“Në të ardhmen, do të vazhdoj t'i angazhoj nxënësit duke gjetur mënyra që t'u jap të gjithëve vetëbesimin se mund ta përdorin platformën dhe të kuptojnë se është një formë argëtuese e të nxënësit.”

Programe edukimi global: përdorimi i tyre në ndihmë të nxënësve dhe një kurrikule që i përgjigjet nevojave të tregut

Nilson Ibraj, Shkolla "Gjergj Canco", Tiranë



Konteksti dhe nevoja

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit është ndoshta fusha me zhvillimin më të shpejtë në botë, duke sjellë vazhdimisht novacion me impakt të madh në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në jetën tonë të përditshme, por edhe anasjelltas, duke iu përgjigjur nevojave të sektorëve që po priren drejt digjitalizimit të proceseve të punës. Për rrjedhojë, kërkesa e tregut të punës për ekspertë të TIK është gjithnjë në rritje. Në këto kushte, edhe institucionet të arsimit profesional të cilët aftësojnë kontigjentin e ardhshëm të këtij segmenti të tregut të punës, duhet të dinë t'i përshtaten dinamikës së fushës, si në dimensionin kurrikular edhe në mënyrën e ndërtimit të orës së mësimi dhe të orientimit të punës së pavarur të nxënësit.

Në drejtimin TIK të shkollës "Gjergj Canco" në Tiranë, mësuesit konstatojnë se përmbajtja e kurrikulës për një pjesë të konsiderueshme të moduleve është e vjetëruar dhe nuk u mundëson nxënësve të ecin me hapin e kohës në zhvillimet e fushës. Mungesa e materialeve mësimore në këto module e bën sfiduese detyrën e mësuesve për të t'u ofruar nxënësve informacionin e duhur. Ndonëse burimet janë të shumta, nuk është e lehtë të përzgjedhësh dhe të përshtasësh informacion, aq më tepër ta përditësosh vazhdimisht atë.

Mësues Nilsoni, instruktor i certifikuar i CISCO, prej disa kohësh përdor CISCO NetAcad në një pjesë të moduleve që zhvillon, duke shfrytëzuar kurrikulën e standardizuar e vazhdimisht të përditësuar në fushën e TIK-ut, si dhe mundësitë e pafundme që kjo akademi virtuale ofron për nxënësit për të praktikuar njohuritë e marra.

SHKOLLA TEKNIKE GJERGJ CANCO

PROBLEMI

Kurrikul e vjetëruar e moduleve dhe materiale mësimore të vështira për t'u hartuar dhe përditësuar nga mësuesit, në një fushë që zhvillohet me shpejtësi.

ZGJIDHJA

Mbështetje në kurrikulën e CISCO NetAcad, si një tërësi materiale mësimore të standardizuara, të hartuara nga ekspertët më të mirë të fushës, me ndërthurje optimale të aspekteve teorike me ato praktike.

REZULTATI

Ofrim nga ana e mësuesve i materialeve mësimore efektive dhe të përditësuara, për një orë mësimore më produktive, si dhe ingranim i plotë i nxënësve në proceset e punës, duke i aftësuar profesionalisht dhe duke i motivuar më tej.

Konteksti dhe nevoja

CISCO NetAcad përfaqëson një program edukimi global mbi teknologjinë e informacionit dhe sigurinë në rrjet, i cili ndër të tjera mbledh një numër të madh institucionesh arsimore. Kjo akademi ofron një kurrikul të pasur dhe të standardizuar, me një numër të madh kurseesh në fushën e rrjeteve kompjuterike, pajisjeve, gjuhëve të programimit, sistemeve të operimit, etj. Nisur nga cilësia e materialeve mësimore të kurrikulës të cilat sigurojnë bazën teorike (rregulla dhe protokolle) dhe praktike (ushtrime dhe projekte) që u duhet nxënësve, mësues Nilsoni ka mbështetur në to realizimin e disa prej moduleve që zhvillon me nxënësit e klasës së XII dhe të XIII. Gjatë orës së mësimi, mësuesi përpaket të jetë racional në kohën që i kushton shpjegimit të koncepteve teorike, me qëllimin për t'i krijuar nxënësve sa më shumë hapësirë për t'u praktikuar. Kështu, falë shfrytëzimit të materialeve mësimore të CISCO NetAcad, si dhe laboratorit të certifikuar nga CISCO, i kompletuar me të gjitha pasijeset e nevojshme, i mundësojnë mësues Nilsonit të realizojë orë mësimore të orientuara drejt praktikës, sipas dy modaliteteve që plotësojnë njëri-tjetrin:

- nëpërmjet simulatorit, një program me një mori pajisjesh dhe mjetesh ku nxënësit praktikohen duke ndërtuar rrjete, duke konfiguruar kompjutera, duke krijuar skema komplekse etj.
- nëpërmjet përdorimit të pajisjeve në laboratorin CISCO, falë të cilave nxënësit vihen në kushte reale pune

Përdorimi i simulatorit nëpërmjet CISCO NetAcad mundëson edhe realizimin e projekteve, të cilat mësues Nilsoni i përfshin rregullisht në procesin mësimor si pjesë e vlerësimit të vetëvlerësimit, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë më mirë ecurinë e tyre dhe nevojat për përmirësim. Pas realizimit të projektit nga nxënësit, zhvillohen diskutime mbi to në klasë apo në Zoom.

Në përdorimin e CISCO NetAcad si bazë kurrikulare dhe e organizimit të orës së mësimi, mësues Nilsoni tregon se ndeshet edhe me vështirësi. Një ndër problemet kryesore ka të bëjë me nivelin e ulët të zotërimit të gjuhës angleze nga ana e një pjese të nxënësve, ndërkohë që për vetë specifikat e fushës dhe mbështetjen në materialet e ofruara online nga CISCO, përdorimi i kësaj gjuhe përbën domosdoshmëri. Gjithashtu, numri i pajisjeve të disponuara në laborator është i kufizuar dhe nuk e mbulon gamën e gjerë të proceseve të që CISCO NetAcad ofron për t'u praktikuar, aq më tepër që ky program përditësohet vazhdimisht. Megjithatë, mësues Nilsoni përpaket t'i kapërcejë këto vështirësi duke u qëndruar pranë nxënësve, duke kuptuar vështirësitë e tyre dhe duke i mbështetur në realizimin e proceseve të punës për të kompensuar mangësitë në aftësi dhe pajisje.

Impakti

Puna me CISCO NetAcad ka impakt pozitiv si te nxënësit, ashtu edhe te mësuesit. Nxënësve u ofrohet qasje falas në një kurrikul ndërkombëtare, të hartuar nga ekspertët më të mirë të fushës dhe që përditësohet vazhdimisht. Falë saj, ata zhvillojnë aftësitë

profesionale më të kërkuara të tregut të punës duke marrë bazat, pra rregullat e funksionimit në fushën e IT-së të cilat mund t'i aplikojnë kudo në të ardhmen, pavarësisht kompanisë në të cilën mund të punësohen. Në CISCO NetAcad, nxënësi gjen gjithçka që i duhet për formimin e tij teorik dhe praktik falë materialeve mësimore të larmishme (tekste, video, ushtrime, kuice etj.), të aksesueshme në çdo moment. Mundësia për të simuluar procese pune nëpërmjet CISCO NetAcad është po ashtu një avantazh, pasi nxënësit njihen dhe përdorin pajisje të cilat nuk mund të disponohen në realitet, si nga specifikat edhe nga numri i madh i tyre. Gjithashtu, falë aftësisë nga CISCO NetAcad nxënësit janë shumëkonkurruar në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit, pasi bëhet fjalë për njëmarkë që njihet kudo.

Impakti është i madh edhe tek mësuesit. Në kushtet kur kurrikula aktuale rezulton e vjetëruar duke mos arritur t'u përcjellë nxënësve risitë e fushës, CISCO NetAcad u jep mundësinë mësueseve për të punuar me një kurrikul të standardizuar, të mirëstrukturuar dhe që ofron mundësi për të ndërtuar një orë mësimore praktike dhe të larmishme në veprimtari, duke ndërthurur konceptet teorike me video, foto, demonstrime praktike dhe instrumente të ndryshme vlerësimi.

Mësimet e nxjerra

Gjatë punës me CISCO NetAcad, mësues Nilsoni ka kuptuar në radhë të parë senëse gjen mënyra për t'i integruar nxënësit në procese pune, gjithçka bëhet më e thjeshtë për t'u përvetësuar. Sipas tij, kur nxënësit prekin nga afër proceset e punës, njëlloj siç do të bëjnë në të ardhmen kur të jenë pjesë e tregut të punës, janë më tepër produktivë, kanë më shumë besim në vetvete dhe priren të japin më të mirën e tyre. Ai sugjeron se çdo mësimdhënës, aq më tepër në fusha të tilla kaq dinamike dhe aplikative sa TIK, duhet krijojë për nxënësit hapësirat e nevojshme për t'u praktikuar në njohuritë e marra. Sipas tij është po aq e rëndësishme që të kuptojmë edhe moshën e nxënësve, perceptimet e tyre mbi procesin e të nxënës, si dhe pengesat që nxënës të caktuar mund të hasin, duke u përpjekur për ta përshtatur procesin mësimor dhe duke ecur me ritmin e duhur.

“CISCO NetAcad ka impakt të madh pasi lehtëson punën e mësuesit, por edhe nxënësit përfitojnë më tepër pasi konceptet përvetësohen më mirë dhe konsolidohen aftësitë më të kërkuara në tregun e sotëm të punës.”



Novacioni në mësimdhënie gjatë pandemisë Praktikat më të mira

RASTE STUDIMORE 2021

Le të mbetemi në kontakt!

 www.aftesiperpune.al

 [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)

 [skills_for_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 [Skills for Jobs Albania](https://www.linkedin.com/company/skills-for-jobs-albania)

 [Aftësi për Punë S4J](https://www.youtube.com/Aftesi_per_Pune_S4J)

Regjistrohuni te buletini ynë: al.info@swisscontact.org